AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Dizajn"**

**ofruar nga**

**Universiteti Privat "Albanian University"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**PhD. Saimir Kristo**

**PhD. Dorina Papa**

**Nëntor/ 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**
**Bachelor në "Dizajn"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Privat "Albanian University" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Art Dizajn |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në 'Dizajn' |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASh Nr. 199, datë 16.05.2012 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Vendim Senati nr. 09, dt. 07.04.2021<br>MAS me shkresë nr. 2600/1, dt. 02.06.2021. |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASR Nr. 394, datë 28.10.2020 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | Nr.78, datë 04.10.2019 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Parë , Bachelor |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli i 6-të |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | Nr. Stafit Viti 2022-2023: 8 PAE/ 8 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | Nr. Stud viti 2020-2021 38<br>2021-2022 76<br>2022-2023 76 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në "Dizajn" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Albanian University" është një hap kyç për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e programit me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ky proces përfshin disa faza kryesore dhe angazhon një sërë aktorësh, duke përfshirë ekspertë të jashtëm, stafin akademik të universitetit, studentët dhe palët e interesuara. Faza e Përgatitjes: Institucioni fillon me përgatitjen e një raporti të detajuar vetëvlerësimi, i cili përmban informacion të gjithanshëm mbi programin, duke përfshirë kurrikulën, metodat e mësimdhënies, kualifikimet e stafit akademik, infrastrukturën, rezultatet e mësimit dhe mundësitë e karrierës për absolventët. Ky raport gjithashtu adreson sfidat dhe planet e përmirësimit.

**Vizita e Ekspertëve të Jashtëm:** Një panel ekspertësh të jashtëm, të përbërë nga akademikë dhe profesionistë të fushës së dizajnit, bëjnë një vizitë në institucion për të vlerësuar programin në bazë të raportit të vetëvlerësimit dhe për të mbledhur të dhëna shtesë përmes intervistave me stafin akademik, studentët dhe palët e interesuara. Ata gjithashtu inspektojnë infrastrukturën dhe resurset e disponueshme.

**Raporti i Vlerësimit të Jashtëm:** Pas vizitës, paneli i ekspertëve harton një raport vlerësimi që përmban vëzhgimet, gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Ky raport trajton aspekte të tilla si përputhshmëria e kurrikulës me objektivat e programit, efektiviteti i metodave të mësimdhënies, cilësia e punës së studentëve, kualifikimet e stafit akademik dhe mbështetja për studentët.

**Plani i Veprimit dhe Përmirësimit:** Bazuar në rekomandimet e raportit të vlerësimit të jashtëm, institucioni zhvillon një plan veprimi për të adresuar çështjet e ngritura dhe për të përmirësuar cilësinë e programit. Ky plan përfshin afate kohore dhe përgjegjësitë specifike për zbatimin e masave përmirësuese.

**Monitorimi dhe Rishikimi**: Institucioni, në bashkëpunim me organet rregullatore të arsimit të lartë, monitoron zbatimin e planit të veprimit dhe bën rishikime periodike për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra dhe për të siguruar që programi vazhdon të përmbushë standardet e cilësisë.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është jetik për të garantuar që programi i Bachelorit në "Dizajn" ofruar nga "Albanian University"jo vetëm të plotësojë kërkesat akademike dhe profesionale të fushës, por edhe përgatisë studentët në mënyrën më të mirë të mundshme për sfidat e tregut të punës dhe për të kontribuar në shoqëri në mënyrë kreative dhe inovative.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtem të programit të studimit Bachelor në "Dizajn" ka synuar të japë një paraqitje sa më të qartë dhe transparente të funksionimit të programit dhe të njësive kryesore dhe bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në këtë mënyrë, ky proces shërben si një mundësi për të kultivuar kulturën e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, si dhe për të ndihmuar në rritjen e cilesise se programit te studimit.

Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në "Dizajn", është përgatitur nga ekspertët; PhD. Saimir Kristo dhe Dr. Dorina Papa të kontraktuar nga kordinatori ASCAL Znj. Rajna Lila.

Për realizimin e këtij raporti, GVJ është mbështetur në të gjitha dokumentet e vena ne dispozicion nga Albanian university ne portalin e ASCAL, ne date 13.11.2023.

Procesi është kryer në tre drejtime kryesore:

- Shqyrtimi i standardeve nga RVB-ja.
- Shqyrtimi i evidencave te vena ne dispozicion nga institucioni.
- Hartimi i draft-raportit.

Konkluzionet e arritura gjatë këtij procesi pasqyrojnë mendimin e anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, të analizuar dhe të argumentuar mbi bazën e standardeve dhe kritereve të përcaktuara. Për arritjen e konkluzioneve, GVJ vizita ne institucion dhe takime e diskutime me zyrat perkatese, pedagoget dhe studentet e programit te studimit si dhe me përfaqësues të njësive dhe strukturave të tjera të pasqyruara në këtë material.

Ky raport paraqet në mënyrë objektive situatën në të cilën është zhvilluar dhe zhvillohet ky program studimi dhe GVJ beson se informacioni i dhënë do të ndihmojë bordin e akreditimit të marrë një vendim sa më objektiv.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.78, datë 04/10/2019 janë:

**Rekomandimi 1:** Institucioni të përcaktojë titullarë lëndesh / modulesh personel akademik të kategorisë "Professor".

**Rekomandimi 2:** Institucioni të zgjeroje dhe të konsolidojë marrëdhënjet e bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit, në kuader të përfshirjes së stafit akademik e studentëve të këtij programi studimi në projektet kërkimore apo programe mobiliteti, si psh. AKKSHI, Horizon 2020, Erasmus + KA1/KA2.

**Rekomandim 3:** Institucioni të vijoj me përditesimin në mënyrë të vazhduar të arkivës së bibliotekës dhe abonimin periodike të fushave specifike të dizajnit.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni:

**Rekomandimi 1: Institucioni nuk e ka përmbushur këtë rekomandim.** Në Programin e Dizajnit nuk ka staf të brendshëm me titullin profesor (Evidencë 2 BSc. Dizajn te dhena stafi akademik v.a 2022-2023.xlsx; Evidenca 4.1a, b, c, d, Mbi ngakesen e stafit akademik nder vite).

**Rekomandimi 2: Institucioni e ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim**, pasi ka aplikuar në projekte Erasmus + në nivel institucional, dhe ka zhvilluar nje projekt bashkepunimi ne vitet 2019-2022. Aktualisht, departamenti ka vetëm një projekt në të cilin do të përfshihen 2 staf dhe 5 studentë (Evideca: R2.a, R2f). Nisur nga eksperienca mbi 10 vjecare e programit, departamenti duhet të kishe një numër më të madh projektesh si dhe të përfshinte më shumë student në aktivitet kërkimore. Sa i përket mobiliteteve dhe shkëmbimit të studentëve, asnjë studentë nuk ka përfituar nga shkëmbimet Erasmus+ (Evidencë: bisedat me studentet, gjatë vizitës në institucion).

Po ashtu, ka një përpjekje për të aplikuar në projekte kombëtare, por institucioni nuk ka marrë ende përgjigje pozitive. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit janë shumë të rralla, pavarsisht MOU-ve, nuk rezulton të ketë bashkëpunime dhe aktivitete konkrete (mungojnë evidencat).

**Rekomandimi 3: Institucioni e ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim.** Biblioteka është abonuar në platformën Elia (Evidence R3.a2), specifike për dizajn, duke iu përgjigjur

disi këtij rekomandimi. Megjithatë, insitucioni duhet të bëj një përpjekje për të pasuruar bibliotekën me libra bashkëkohor për të njohur trendet më të fundit, qoftë edhe në gjuhën angleze, pasi për vetë natyrën e degës, këto libra janë më shumë illustrative. Një pjesë e mirë e teksteve në shqip që disponon biblioteka e institucionit janë të tejkaluara për kohën. (Evidenca: 4.8).

*Universiteti Privat "Albanian University", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 177 / 28 Prot, datë 03.10.2024. Universiteti Privat "Albanian University", njofton në ASCAL më datë 10.10.2024, me anë të shkresës me Nr.345/1 Prot, datë 10.10.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit",* ***IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 345/1 Prot, Datë 10.10.2024.***

**Përgjigje mbi "Komente mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm"**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**"Dizajn"**

**Albanian University**

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për **Rekomandimi 3.**

**GVJ:** Biblioteka është abonuar në platformën Elia (Evidence R3.a2), specifike për dizajn, duke iu përgjigjur disi këtij rekomandimi. Megjithatë, insitucioni duhet të bëj një përpjekje për të pasuruar bibliotekën me libra bashkëkohor për të njohur trendet më të fundit, qoftë edhe në gjuhën angleze, pasi për vetë natyrën e degës, këto libra janë më shumë illustrative. Një pjesë e mirë e teksteve në shqip që disponon biblioteka e institucionit janë të tejkaluara për kohën. (Evidenca: 4.8).

**GVB:** Per kete rekomandim nuk eshte here vleresimi nese eshte plotesuar (plotesisht, pjeserisht, kryesisht) ose jo.

**GVJ:** GVJ merr në konsideratë komentin e bërë nga Institucioni në lidhje percaktimin e vleresimit sipas shkalles se kerkuar, dhe e ka reflktuar ate ne RVJ.

**Raporti në këtë pikë ndryshon si më poshtë:**

Rekomandimi 3: *Institucioni e ka përmbushur pjesërisht këtë rekomandim.* Biblioteka është abonuar në platformën Elia (Evidence R3.a2), specifike për dizajn, duke iu përgjigjur disi këtij rekomandimi. Megjithatë, insitucioni duhet të bëj një përpjekje për të pasuruar bibliotekën me libra bashkëkohor për të njohur trendet më të fundit, qoftë edhe në gjuhën angleze, pasi për vetë natyrën e degës, këto libra janë më shumë illustrative. Një pjesë e mirë e teksteve në shqip që disponon biblioteka e institucionit janë të tejkaluara për kohën. (Evidenca: 4.8).

2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi 1.1 , Kriteri 3, Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.

**GVJ:** Institucioni duhet te perditesoje Statutin, per te siguruar ofrimin e vazhdueshem te nje programi cilesor dhe per te parashikuar burimet financiare dhe infrastrukturen per te mbeshtetur zhvillimin e programit, si dhe per te stimuluar kerimin shkencor ne kete fushe. Statuti ekzistues i evidentuar mbulon periudhen deri ne vitin 2022.

**GVB:** Per sa i perket statutit ai eshte miratuar nga MAS me urdher nr. 380 date 14.07.2023 [Evidence nr.1]

**GVJ:** GVJ se statuti i publikuar ne website dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe i vene ne dispozicion te grupit te vleresimit ishte i paperditesuar. Grupi i vleresimit te jashtem vlereson faktin qe Albanian University disponon nje statur te ri te miratuar, por mos publikimi i tij mund të tregojë mungesë të transparencës ndaj stafit, studentëve, dhe palëve të interesuara që kanë të drejtë të informohen për rregulloret që drejtojnë institucionin. Universiteti ka për detyrë të sigurojë që çdo ndryshim ose përditësim i rëndësishëm të jetë lehtësisht i aksesueshëm për publikun.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi 1.2 , Kriteri 2: Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.

**GVJ:** Numri i studenteve qe kryejne mobilitete ne vendet e BE eshte mjaft i reduktuar. Per disa vite akademike rresht, nuk ka patur fare mundesi mobiliteti (bazuar ne biseden me studentet gjate vizites ne Institucion).

**GVB:** Institucioni ka marre masa dhe e ka pasur ne vemendje kete mangesi dhe se fundmi ka nenshkruar marreveshje ne kuader te Erasmus + me "Institute of Higher Education for Industrial Art and Design", ISIA FAENZA, Itali [Evidence nr.3).

**GVJ:** GVJ e vlereson vullnetin e universitetit per te permbushur kete mangesi, por deri ne momentin e vleresimit konstatimi i GVJ eshte ai i deklaruar me siper.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

4. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi 1.2 , Kriteri 4**: Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

**GVJ**: Rekomandohet te lidhen marreveshje me studio dhe agjenci reklamash prestigjioze ne nivel kombetar dhe nderkombetar, per te pergatitur studentet per t'i bere ata me konkurrues ne treg, por edhe per te realizuar vizita studimore dhe shkembim eksperience.

**GVB**: Institucioni ka lidhur marreveshje me studio dhe agjenci reklamash prestigjoze me qellim pergatitjen sa me mire te studenteve per realizimin e vizitave studimore si dhe shkembim eksperiencash [Evidence nr.4].

**GVJ**: GVJ nuk mohon qe universiteti ka lidhur marreveshje me studio dhe agjenci reklamash, por sugjeron, nisur nga prezenca e studiove prestigjoze nderkombetare ne Tirane e me gjere, qe universiteti te zgjeroj rrjetin e marreveshjeve te bashkepunimit me studio te nje niveli me te larte nderkombetare, dhe me prestigjoze.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

5. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.I, kriteri 2**: Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

**GVJ**: Ne Rregulloren e Programit te Studimit (Evidenca H.1) sugierohet te specifikohen fushat e ekspertizes dhe te punesimit per studentet qe kryejne kete program.

**GVB**: Ne rregulloren e programit te studimit tek objektivat specifike, citohet perkatesisht:

1. Gjate vitit te pare akademik, programi Bachelor ne "Dizajn" ka si synimin t'u ofroje studenteve njohuri te pergjithshme dhe specifike te programit, mbeshtetur ne lende te formimit baze, plotesues dhe nderdisiplinor.

2. Gjate dy viteve te tjera akademike, studenti do te thelloje njohurite qe perkojne me profilin e diplomes Bachelor ne "Dizajn". Ne kete kuader vendosen objektiva specifike per pergatitjen e eksperteve te afte per te operuar ne kete fushe, por edhe per te qene te afte te integrohen ne studio, kompani apo institucione me karakter specifik ne fushen perkatese.

3. Vien per t'u theksuar se qellimi i kurrikules eshte t'u ofroje studenteve njohuri te cilat do te jene te nevojshme edhe per te ndjekur ciklet e tjera te njepasnjeshme te studimit dhe ne te njejten kohe t'u pergjigjet kerkesave me te cilat do te perballen studentet gjate realizimit te tyre profesional.

4. Ne kete menyre, ne perfundim te ketij programi, studentet do te zoterojne kapacitetet analitike dhe konceptet e nevojshme per te trajtuar problematikat e ndryshme te dizajnit duke u pajisur dhe me shprehi te vevanta te lidhura me fushen perkatese te studimit [Evidence nr.5].

**GVJ**: GVJ ve ne dukje qe ne rregulloren e programit te studimit duhet te theksohen fushat specifike te dizajnit dhe te punesimit te studenteve, gje qe nuk eshte e percaktuar. Duke qene se koncept i Dizajnit eshte shume i gjere, te vihet ne dukje fusha specifike e ekspertizes psh. Dizajn grafik, Dizajn industrial apo dizajn produkti, dizajn multimedia, dizajn interieri, etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

6. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.2, kriteri 1**: Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

**GVJ**: Numri i stafit akademik ne Departamentin e Art Dizajnit ka ardhur ne renie nga 10 staf akademik i brendshem ne vitin akademik 2019-20 ne 7 staf akademik i brendshem ne vitin akademik vitin 2022-23. Po ashtu edhe stafi akademik i jashtem eshte zvogeluar ne numer, nga 8 ne 2019-20 ne 6 ne vitin akademik vitin 2022-23.

**GVB**: Ne lidhje me stafin akademik, institucioni 2 here en vit realizon procesin e rekrutimit per staf akademik efektiv ( PAE) dhe staf te jashtem (PAK). Deprtamenti angazhohet cdo vit per rekrutimin e stafit akademik te kualifikuar si dhe duke ju permbajtur edhe akteve ligjore ne fuqi, neni 25, Ligji nr. 80, 2015, pika 4 "Departamenti ka ne perberjene tij te pakten shtate anetar, te punesuar me kohe te plote, si personel akademik nga te cilet te pakten tre me grada shkencore ose tituj akademik. Departamenti mund te kete ne perberje edhe personel ndihmes akademik".

**GVJ**: GVJ nuk vë në dyshim përmbushjen e kriterit minimal ligjor, por evidenton, në aspektin cilësor, ndryshime që mund të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies, që është qëllimi final i përmbushjes së kritereve.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

7. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.4, kriteri 1**: Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.

   **GVJ**: Megjithate programi ofron aftesim kryesisht ne fusben e artit dhe pjeserisht dizajnit grafik. Per te punuar ne fushat e tjera duhet te ofrohet mundesi per specializim te metejshem ne nivelin e studimeve te larta master.
   **GVB**: Universiteti ofron programin e studimit Master Profesional ne "Interier Dizajn", gjithashtu eshte aplikuar ne MAS edhe per hapjen e nje programi Master Profesional ne Master Profesional ne "Art dhe Dizajn" me profile: Profili Interier Dizajn /Profili Grafike artistike /(Printmaking) Profili Web Dizajn.

**GVJ**: GVJ nuk ka qene ne dijeni ne momentin e vleresimit per kete program te ri qe eshte ne proces aplikimi dhe institucioni nuk e ka deklaruar ne GVJ. GVJ vlereson perpjekjen e Unviersiteti per te ofruar specilizim te metejshme ne keto fusha studimi.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.4, kriteri 5**: Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.

**GVJ**: Ne fushen e Dizajnit, tekstete ne gjuhen shqipe mungojne disi. Per te kompensuar kete mungese, departamenti mund te investoje ne blerjen e botimeve te buaja ne formatin hard copy apo digjital, si dhe ne abonime per revista te specializuara ne interier dhe dizajn grafik. Kjo do te siguronte nje game me te gjere te burimeve per studentet dhe pedagoget ne fushen e Dizajnit.

**GVB**: Institucioni ka vijuar pasurimin e arkives se bibliotekes me tituj te fushes se artit dhe dizajnit. Albanian University, Departamenti i Art Dizajnit, eshte tashme anetare e rrjetit evropian ELIA[Evidence nr.6], qe lidhet drejtperdrjt me fushen e artit dhe dizajnit, nje rrjet evropian i arsimit te larte ne arte, i cili laijon mundesi te reja per anetaret e saj, duke lehtesuar shkembimin e praktikave me te mira; studentet kane mundesi te konsultojne 7 librari online[Evidence R3.b ne RVB).
Gjate bashkepunimeve me institucione te ndryshme si Akademia e Shkencave, Komuniteti Ortodoks etj. kemi patur mundesi te shtojme numrin e librave te fushes se artit dhe dizajnit ne 125 tituj[Evidence 4.8 ne RVB). Gjate ketyre viteve studentet e AU kane qene dhe vijojne te jene pjese ne trajnimet e ndryshme te digjitalizimi te mjeteve te informimit te Drejtorise se Pergjithshme te Arkivave dhe Bibliotekes Kombetare qe kane mundesuar perdorimin ne kohe reale (online) te materialeve qe disponojne keto institucione [Evidence nr.7).

**GVJ**: GVJ vlereson fatin qe ne shume lende perdoret literature ne gjuhen shqipe e botuar vitet e fundit, por evidenton qe kjo literature nuk e perditesuar, jo ne aspektin e vitit te botimit, por ne permbajtje dhe cilesi. Prandaj vlen sugjerimi per pasurimine bibliotekes me tekste te huaja. apo revista te specializara ne hap me kohen. Burimet te citohen me siper nga GVB si dhe bashkepunimet e keto institucione, kane impakt te kufizuar ne fushen e dizajnit bashkekohor. Psh, si Akademia e shkencave edhe Komuniteti Ortodoks nuk jane institucione relevante ne fushen e dizajnit.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

9. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.1: Konkluzione:**

**GVJ**: Limitet e formularit te Vleresimit nga Studentet: Formulari i perdorur per vleresimin e mesimdhenies mund te kete kufizime qe pengojne studentet te shprehin mendimet e tyre me te hollesishme mbi metodat e mesimdhenies dhe te japin propozime konkrete.

**GVB:** Njesia e Sigurimit te Brendshem te Cilesise (NJSBC) realizon 2(dy) here ne vit pyetesorin e studenteve per procesin mesimor, i cili perbehet nga 6 pohime, te cilat kerkojne nje pergjigje me shkallen Likert, dhe 2 pyetje ku ne fillim studenti zgjedh vitin ne te cilin studion dhe ne pyetjen e fundit ka te drejten te shpreh mendimin e tij per sugjerime ose problematika (nese ka) [Evidence nr.8).
Gjithashtu, NJSBC realizon 1 (nje) here ne vit fokus grupet me nje grup studentesh te perzgjedhur ne menyre rastesore, ku studentet shprehin mendimet e tyre ne lidhje me mbarevajtjen e procesit mesimor, stafin akademik, etj [Evidence nr.9).

**GVJ**: GVJ vëren se permbajtja e pyetesorit eshte e pergjithshme ne nivel departamenti, jo specifik per secilen lende gje qe do të përmirësonte cilësinë e të dhënave të mbledhura për mësimdhënien, duke mundësuar një analizë më të thelluar dhe të individualizuar për secilën lëndë dhe pedagog. Kjo strukturë, edhe pse plotësohet nga takime të fokus-grupeve, mund të kufizojë detajet që janë specifike për lëndë të caktuara dhe metoda të ndryshme mësimdhënieje.
Për të rritur cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të studentëve, GVJ rekomandon që formulari të bëhet më i specializuar për secilën lëndë dhe të përfshijë pyetje që lejojnë një vlerësim më të plotë dhe specifik. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin cilësor të feedback-ut të marrë nga studentët dhe në përmbushjen më efektive të standardeve të cilësisë në mësimdhënie, që është qëllimi final i institucionit.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

10. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.2, kriteri 4:** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.

**GVJ**: Sugjerohet qe Departamenti te krijoj edhe nje laborator per printimin dhe prodhimin si dhe laborator per krijimin e imazheve dixhitale.

**GVB:** Universiteti ka ne strukturen e tij shtypshkronjen "AU PRESS", e cila eshte ne dispozicion te pedagogeve dhe studenteve per te gjitha nevojat e tyre per printimin dhe prodhimin e imazheve digjitale, te botimeve te ndryshme, projekteve dhe diplomave te diplomanteve.

**GVJ**: GVJ nuk sugjeron nje strukture qe merret me printim projektesh apo diplomash, por per nje ambjent pune per studentet, te pajisur me aparatura teknologjike që mbështesin proceset e printimit dhe prodhimit fizik, si p.sh., printerë 3D, printerë industrialë, makineri për prerjen e materialeve te maketeve, pajisje për prototipizim, per stampim te produkteve grafike etj. Kjo do t'u mundësojë studentëve të zhvillojnë aftësitë praktike për të realizuar produktet e tyre në formë fizike dhe të mësojnë proceset e prodhimit në dizajn.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

11. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.3, kriteri 1:** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.

**GVJ**: Sugjerohet perditesimi i literatures, me tekste teh, te pakten ne lendet specifike te dizajnit, ku edhe permbajtja eshte me vizuale, sesa teorike.

**GVB:** Perditesimi i literatures nga ana e Departamentit realizohet duke iu ofruar studenteve dhe pedagogeve mundesine e aksesit nepermjet platformave online te librarive elektronike dhe bibliotekave online. Albanian University, Departamenti i Art Dizajnit, eshte tashme anetare e rrjetit evropian ELIA, qe lidhet drejtperdrejt me fushen e artit dhe dizajnit, nje rrjet evropian i arsimit te larte ne arte, i cili krijon mundesi te reja per anetaret e saj, duke lehtesuar shkembimin e praktikave me te mira; studentet kane mundesi te konsultojne 7 librari online.

**GVJ**: Anëtarësimi i Departamentit në rrjetin evropian ELIA, një burim i çmuar për fushën e artit dhe dizajnit, duhet të reflektohet gjithashtu në bibliografitë e sillabuseve, duke ofruar referenca të qarta për aksesin e studentëve në këto materiale përmes platformave të disponueshme.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

12. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi V.1 Konkluzione**

**GVJ**: Pika kritike, ne kete aspekt qendron ne mungesen e dokumentacionit te qarte dhe evidencave konkrete, gje qe i ben deklaratat dhe politikat te jene te paqarta dbe te pasigurta per publikun dhe aplikantet. Institucioni duhet te siguroje dokumente te hollesishme dhe transparente per te mbeshtetur dhe konfirmuar kuotat e deklaruara.

**GVB:** Institucioni miraton me Vendim Senati Akademik kuotat per secilin program studimi [Evidenca nr.10].

**GVJ**: Institucioni duhet te jete me transparent ne publikimin ne kohe te ketij informacioni ne website.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

13. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi V.2 Konkluzione**

**GVJ**: Rregullorja e programit te studimit ofron informacion te plote dhe te hollesishem ne lidhje me kriteret dhe procedurat e perparimit akademik te studenteve nga nje vit akademik ne tjetrin, mbi regjistrimin, transferimet dhe kriteret e procedurat e diplomes. Megjithate ne disa aspekte kjo rregullore nuk respektobet me perpikmeri. Perkunder pretendimeve ne rregullore, nga takimi me studentet, rezulton se ata nuk jane ende informuar mbi procedurat e perzgjedhjes se temes se diplomes dhe procedurat e diplomimit. Kjo moskuptim mund te shkaktoje vonesa dhe mos kenaqesi tek studentet, si dhe te ndikoje ne pergatitjen e tyre per kete faze te rendesishme te studimeve.

**GVB:** Sipas programit, studentet ne fillim te semestrit te dyte te vitit akademik marrin informacion nga departamenti ne lidhje me procesin e ecurise se realizimit te diplomes.

Tek te gjithee studente dergohet nje udhezues: "Udhezues diplome, Programi i Studimit Bachelor ne Dizajn, ku shpjegohen te gjitha kerkesat dhe detyrat per procesin e diplomimit. Ne vazhdim studentet dorezojne prane departamentit nje deklarate me kerkesen e tyre per miratim te temes se diplomes dhe udheheqesit. Gjate semestrit te dyte behen konsultime cdo jave me udheheqesit e diplomave dhe firmoset nga pedagogu shkresa e dates se konsultimit, e cila ne fund te semestrit dorezohet prane departamentit. Gjate kesaj periudhe krijohen komisionet prej 3 anetaresh per kontrollet e diplomes dhe mbahen procesverbalet perkatese sipas datave te caktuara. Finalizimi me dorezimin dhe mbrojtjen e diplomes ndodh pas kalimit me sukses te gjitha procedurave te mesiperme.

**GVJ**: Rregullorja e programit të studimit përmban udhëzime të qarta dhe të detajuara për kriteret dhe procedurat që lidhen me përparimin akademik, regjistrimet, transferimet dhe procesin e diplomimit. Megjithatë, në disa aspekte, zbatimi i rregullores nuk ndiqet me përpikëri. Në kundërshtim me informacionin e dhënë në rregullore, nga takimi me studentët rezulton se ata nuk janë informuar plotësisht mbi procedurat e përzgjedhjes së temës së diplomës dhe procesin e diplomimit. Ky mangësim në informim mund të shkaktojë vonesa dhe pakënaqësi, si dhe të ndikojë negativisht në përgatitjen e studentëve për këtë fazë të rëndësishme të studimeve.
Sipas rregullores së programit (Evidenca H.1, neni 29), procesi i diplomimit duhet të nisë një muaj pas fillimit të vitit akademik, dhe jo në semestrin e dytë, siç është përmendur në përgjigjen e institucionit. Sugjerohet që rregullorja të respektohet dhe studentët të informohen në kohën e duhur për të siguruar një proces të qartë dhe të mirëorganizuar.

14. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi VI.1, kriteri 2**: Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

**GVJ**: Megjithate, pyetesoret jane shume te pergjithshem dhe nuk lejojne te vleresojne ne menyre te detajuar aspekte te ndryshme te mesimdhenies dhe mbarevajtjes se lendes nga pedagogu.

**GVB:** Megjithate, pyetesoret jane shume te pergjithshem dhe nuk lejojne te vleresojne ne menyre te detajuar aspekte te ndryshme te mesimdhenies dhe mbarevajtjes se lendes nga pedagogu.

**GVJ**: GVJ vëren se permbajtja e pyetesorit eshte e pergjithshme ne nivel departamenti, jo specifik per secilen lende gje qe do të përmirësonte cilësinë e të dhënave të mbledhura për mësimdhënien, duke mundësuar një analizë më të thelluar dhe të individualizuar për secilën lëndë dhe pedagog. Kjo strukturë, edhe pse plotësohet nga takime të fokus-grupeve, mund të kufizojë detajet që janë specifike për lëndë të caktuara dhe metoda të ndryshme mësimdhënieje.

Për të rritur cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të studentëve, GVJ rekomandon që formulari të bëhet më i specializuar për secilën lëndë dhe të përfshijë pyetje që lejojnë një vlerësim më të plotë dhe specifik. Kjo do të

kontribuonte në përmirësimin cilësor të feedback-ut të marrë nga studentët dhe në përmbushjen më efektive të standardeve të cilësisë në mësimdhënie, që është qëllimi final i institucionit.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

15. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi VI.3 Konkluzione**

**GVJ**: Sistemi i vleresimit e cilesise te perdorur aktualisht nga universiteti, nuk nxjerr ne pah problematika dhe ceshtje qe mund te jene subjekt permiresimi. Universiteti duhet te perdor sistemin e trefisht te vleresimit te cilesise: a. vleresimi i studenteve per pedagoget dhe mesimdhenien, b. vleresimi i pedagogut nga koleget, dhe c. vetevleresimi i pedagogut. Ky sistem duhet te jete i detajuar ne cdo ze.

**GVB:** Institucioni e disponon dhe e perdor sistemin e trefishte te vleresimit te cilesise, konk.retisht:

a. Vleresimi i studenteve per pedagoget dhe mesimdhenien (pyetesori i studenteve dhe fokus grupet) [Evidence nr.8]

b. Vleresimi i drejtuesit te departamentit per pedagogun (Formulari i vleresimit te drejtuesit per pedagogun) (Evidence nr.11]

c. Vetevleresimi i pedagogut (Raporti i vetevleresimit te pedagogut) [Evidence nr. 3.8 ne RVB]

**GVJ**: GVJ vëren se sistemi i trefishtë i vlerësimit për cilësinë e mësimdhënies është një praktikë e vlefshme, por përmirësimi i mëtejshëm mund të arrihet duke rritur nivelin e detajeve në pyetësorët e përdorur. Aktualisht, përmbajtja e pyetësorit është e përgjithshme për nivelin e departamentit dhe nuk është specifike për secilën lëndë. Kjo strukturë kufizon thellësinë dhe individualizimin e analizës për çdo lëndë dhe pedagog, dhe për pasojë, mund të mos adresojë specifikat e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe karakteristikat unike të çdo kursi.

Për të përmirësuar cilësinë e feedback-ut dhe për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të studentëve, GVJ rekomandon që formulari të përshtatet për secilën lëndë dhe të përfshijë pyetje që mbështesin një vlerësim më të hollësishëm dhe të specializuar. Kjo do të kontribuonte në mbledhjen e të dhënave më cilësore, të cilat do të ndihmonin në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.

Gjithashtu, evidencat e paraqitura (Evidenca 8 dhe Evidenca 11) nuk përmbajnë për pyetësorët, fokus-grupet apo për vlerësimin e drejtuesit të departamentit për pedagogët. Nga ana tjetër, vetëvlerësimi i pedagogëve nuk përmban komente të synuara për përmirësime të mundshme apo objektiva më të larta në mësimdhënie. Përmbushja e këtyre aspekteve do të ndihmonte në një përmbushje më efektive të standardeve të cilësisë që janë objektiv kryesor i institucionit.

**Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

16. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi VI.4 , kriteri 5:** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.

**GVJ**: Institucioni nuk ka krijuar nje laborator te dedikuar per modelim dhe realizimin e maketeve.

**GVB:** Ne godinen e Fakultetit ndodhen dy laboratore; i grafikes dhe i piktures monumentale. Maketet realizohen ne keto ambiente gjate oreve te praktikes te lendeve perkatese nen mbikeqyrjen e pedagogeve. Salla 402 dhe 303 disponojne makete dhe materiale grafike fizike te realizuara nga studentet: • Mozaike me element te ndryshem si psh: gur, xhama, pllaka, tulla, letra, etj

- Vitrazhe (piktura ne xham)
- Vizatime
- Piktura ne telajo
- Makete te realizuara nga diplomat e studenteve
- Printime digjitale nga realizimet grafike te studenteve

**GVJ**: GVJ pranon mospershtatshmerine komentit me kriterin. Megjithate kjo nuk do te thote qe komenti nuk eshte i vlefshem, por eshte lene ne kriteret specifike te raprotit qe kane nje lidhje me te drejtperdrejte me kete aspekt.

**Raporti është ndryshuar.**

17. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi VI.5 , Konkluzione.**

**GVJ**: Mungesa e reflektimit te pikave kritike te raportit final ne vitin pasardhes: Raporti vjetor shoqerohet me nje plan masash dhe nje plan veprim per vitin e ardbsbem, por masat e marra jane te pakta dhe nuk reflektojne ne menyre te mjaftueshme problematikat dhe potencialet e identifikuara ne analizen SWOT.

**GVB:** Njesia baze harton raporte vjetore mbi bazen e nje modeli, perkatesisht sipas pikave te meposhtme:

1. Programet e studimit
2. Stafi akademik
3. Mesimdhenia dhe studentet
4. Financimi
5. Kerkimi shkencor
6. Bashkepunimi brenda dhe jashte vendit
7. Aplikimi ne projekte kombetare dhe nderkombetare
8. Mobiliteti i stafit akademik dhe studenteve

9. Analiza SWOT, si dhe masat e marra nga departamenti per permiresimin e pikave te do beta te tij
*Tek hyrja, secili nga departamentet ben nje analize vleresuese mbi permiresimin e pikave te dobeta te pasqyruara ne raportin vjetor te vitit paraardhes, si dhe progresi qe ka bere departamenti gjate kesaj periudhe.

**GVJ**: GVJ vlerëson përmbajtjen e raportit vjetor dhe përpjekjet e njësisë bazë për të adresuar kritikat dhe rekomandimet e raportit të akreditimit. Megjithatë, GVJ vëren se jo të gjitha rekomandimet janë adresuar në mënyrë të plotë dhe të mjaftueshme.

Raporti përfshin një analizë të gjerë, por mungon një reflektim i thelluar dhe konkret mbi masat e nevojshme për përmirësimin e pikave kritike të identifikuara në analizën SWOT. Përmirësimi i qëndrueshëm kërkon që plani i masave dhe plani i veprimit për vitin pasardhës të pasqyrojë plotësisht problematikat dhe potencialet e raportuara, duke përfshirë hapa të qartë për përmirësime në fusha kyçe.

Konsiderohet e nevojshme që në raportin e ardhshëm vjetor të sigurohet një ndjekje më e strukturuar e përmbushjes së rekomandimeve, duke shpjeguar progresin e bërë dhe masat konkrete për adresimin e mangësive të identifikuara.

**Raporti nuk është ndryshuar.**

18. Lidhur me komentin e institucionit për: Në Draft Raportin e Vleresimit të Jashtëm për programin e studimit bachelor në "Dizajn", në vleresimin e fushës V vihet re: nga 6 (gjashte) standarde që ka fusha 5, standardet (V.2;V.3;V.4;V.5;V.6) janë vleresuar plotesisht dhe vetem standardi V.1 kryesisht dhe në fund fusha është vlerësuar me plotësisht.

**Raporti është ndryshuar, duke reflektuar rekomandimin.**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**
**Prof. Asoc. Saimir Kristo**
**Dr. Dorina Papa**



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

# I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit në Dizajn i ofruar nga Departamenti i Artit të Dizajnit përputhet me interesat kombëtare dhe promovon vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Për më tepër, ky program synon të përmbush nevojat e tregut vendas të punës, duke ndikuar në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetesës, përmirësimin estetik të hapësirave të jetesës, promovimin e identitetit kulturor dhe krijimin e një ambienti inovativ. Gjithashtu, ai luan një rol kyç në rritjen e imazhit të bizneseve dhe markave, duke shtuar vlerë në tregun vendas dhe ndërkombëtar. Ky program inkurajon inovacionin dhe kreativitetin, duke përmirësuar jetën kulturore dhe ekonominë e vendit. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit në Dizajn hartohet dhe ofrohet nga Deprtamenti i Art Dizajnit në përputhje me qëllimet dhe misionin e Albanian University. Misioni i AU është të ofroj programe studimi në të gjithë ciklet e studimit dhe të ndihmoj në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar e rajonal gjë që ky program studimi e mundëson nisur edhe nga nevojat e tregut dhe specifikat e tij si master professional.<br><br>**(Evidenca 1.3, Neni 2, Neni 7).** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programi i studimit Bachelor në "Dizajn" është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të universitetit, në përputhje me Statutin 2017-2022 dhe Rregulloren e institucionit, si dhe me fushat dhe drejtimet akademike të tij **(Evidenca 1.5, a, b).** Po ashtu, ai ndërtohet në përputhje me planin e veprimeve për realizimin e objektivave **(Evidenca 1.5 b).**<br><br>*Institucioni duhet të përditësojë Statutin, për të siguruar ofrimin e vazhdueshëm të një programi cilësor dhe për të parashikuar burimet financiare dhe infrastrukturën për të mbështetur zhvillimin e programit, si dhe për të stimuluar kërkimin shkencor në këtë fushë. Statuti ekzistues i evidentuar mbulon periudhën deri në vitin 2022.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Institucioni ka një përvojë prej 11 vitesh në fushën e Dizajnit. Megjithatë, është e nevojshme që institucioni të rrisë kapacitetet e ekspertizës njerëzore, duke përfshirë më shumë lektorë me njohuri të specializuara në fushën e Dizajnit, veçanërisht breza te rinj me përvojë profesionale dhe akademike të diplomuar në dizajn, nje fushe e re, e lidhur me teknologjine dixhitale dhe e ndryshme nga artet e bukura. |

Aktualisht, stafi i departamentit ka kryesisht ekspertizë në fushën e arteve por është mjaft e kufizuar ekspertiza në fushën e dizajnit grafik dhe komunikimit vizual, që është thelbi i këtij programi **(Evidenca 4.2).** Për pasojë mjaft lëndë kanë një orientim artistik, sesa në këndvështrimin e dizajnit që nuk është vepër artistike e mirëfilltë, pasi ka një qëllim dhe funksion të caktuar si psh.
Lënda Histori arti 1,2, që trajton artin nga antikiteti deri në ditët e sotme, trajton gjerësisht artin prehistorik, antikitetin dhe i le shume pak vend artit bashkëkohorë dhe aspak dizajnit **(Evidenca 2.6.1,2).** Kjo lëndë mund të emërtohet Histori arti dhe dizajni 1,2, ose Histori Dizajni 1,2, ose Histori arti dhe Histori Dizajni në dy semestral.

*Gjithashtu, ka mospërputhje midis përmbajtjes së lëndës dhe profilit të pedagogut. Psh. Lënda Art 2D/1 jepet nga Pedagogu i profilit inxhinierisë* ***(Evidenca 4.1a)****.*
Shpemdarja e ngarkeses nuk është e balancuar. Ka pedagogë të brendshem që mbulojne rreth 885 orë vjetore (413+472), si psh Dr. Sh. B. dhe pedagog të brendshëm si psh. E. B. që mbulojne 135 +77 orë. Kjo bën që një pjesë e mirë e lendëve të planit të studimit ti jepen studentit nga i njëjti pedagog **(Evidenca 1.4.b).** Kjo është dukshme edhe në vitet akademike në vijim 21-22 dhe 22-23 **(Evidenca 1.4.c, d).** Në këtë aspekt sugjerohet që të ketë një shpërndarje më të balancuar të ngarkesës tek pedagogët e brëndshëm.

Institucioni disponon bazën materiale minimale në fushën e dizajnit **(Evidenca 1.6),** duke orfuar laboratorë me programet e si Adobe suite, 3d max, Cad etj.

Megjithate, universiteti duhet të ofroj edhe laboratore me kompiuter më të përditësuar dhe hapësira pune për printimin dhe prodhimin. Ato duhet të përmbajnë printera për metoda të ndryshme printimi (inkjet, lazer, etj.), prerëse letre, makina lidhëse dhe mjete të tjera të përdorura në prodhimin e dizajneve fizike. Laboratorët aktual lidhen me punime artistike tradicionale si qeramike, pikturë monumentale, mozaik, jo printime apo prodhime të tjera dixhitale.
Po ashtu, universiteti duhet të investoj një laborator të imazheve dixhitale, të pajisur, kamera me cilësi të lartë, kuti fotografimi të objekteve apo produkteve të dizajnit dhe softwer për manipulimin e imazhit dhe fotografimin dixhital, duke i lejuar studentët të punojnë dhe të modifikojnë elemente vizuale për lëndë si Multimedia dhe Fotografi.

*Kjo do të ndikojë në përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës, duke zhvilluar aftësi praktike digjitale dhe duke i bërë ata konkurrues në industrinë e dizajnit.*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fusha e programit të studimit është në përputhje me atë të njësisë akademike përgjegjëse për programin, Departamenti i Artit të Dizajnit, dhe është bazuar në udhëzimet dhe standardet evropiane për arsimin e lartë. Departamenti i cili është përgjegjës për programin përfshin fushën kërkimore të shkencave të aplikuar **(Evidenca 1.7, Neni 1)** që është një nga fushat kërkimore të Fakultetit të Shkencave të aplikuara dhe ekonomike.<br><br>Universiteti është në proces për kodifikimin e Programit të "Dizajnit" sipas Udhëzimit të MAS Nr. 31, date 15.11.2022. |
| **Konkluzione** | *Ky program ka një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, imazhin e bizneseve dhe markave, duke plotesuar një nevoje të tregut dhe duke shtuar vlerë në tregun vendas dhe ndërkombëtar.*<br>*Megjithate, pas 11 vitesh përvoje, departamenti duhet të rrisë kapacitetet njerezore, duke rekrutuar staf të specializuar me ekspertizë jo vetëm në artet tradicionale, por edhe në fushat e reja të dizajnit, duke përfshirë dizajnin UX/UI, dizajnin e ndërveprimit, grafikën në lëvizje, animacion, etj.*<br>*Gjithashtu, infrastruktura duhet të përmiresohet dhe zgjerohet duke shtuar hapësira pune me kompiuter si dhe hapësira për prototipimin, ku studentët mund të eksperimentojnë me dizajnin fizik të produktit, prototipizimin e shpejtë dhe printimin.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Albanian Unviersity mundëson marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit duke ndarë detyrat mes njësive dhe personelit për të siguruar për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit.<br><br>Ky insitucion bën të mundur identifikimin e problematikave dhe adresimin e tyre për të përmirësuar cilësinë e programeve dhe duke siguruar që ato përputhen me standardet e nevojshme akademike dhe profesionale, përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm nëpërmjet NJSBC-së. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | NJSBC analizon punën e personelit dhe njësive të ndryshme dhe siguron që programi i studimit të jetë në zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm brenda mundësive ligjore. Përmes vlerësimit të kujdesshëm të performancës, institucioni mund të identifikojnë zonat ku nevojiten përmirësime dhe të ndërmerren veprime për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e programeve të tyre të studimit si dhe për ti administruar ato sa më mire. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Aktualisht, institucioni ka vetëm 6 marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe në Shqipëri dhe Kosovë (Evidenca 1.2, d) dhe një projekt Erasmus + në fushën e dizajnit **(Evidenca R.2.a, b, c.1, c.2, d, e, f).**<br>Pas 11 vitesh experience, institucioni duhet të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimit me institucione homologe, brënda dhe jashtë vendit, për të mundësuar bashkëpunimin në këtë fushë akademike, aq më tepër që këto bashkëpunime nuk janë konkretizuar në projekte reale, por janë thjeshtë marrëveshje në letër.<br>*Numri i studenteve që kryejnë mobilitete në vendet e BE është mjaft i reduktuar. Për disa vite akademike rresht, nuk ka patur fare mundësi mobiliteti **(bazuar në bisedën me studentët gjatë vizitës në Institucion).***<br>Kjo është vënë në dukje edhe nga vetë stafi i Programit, Dekani i Fakultetit, por edhe nga studentet gjatë takimeve me grupet e ndryshme, gjatë vizitës në institucion.<br>Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe duhet të konkretizohen nëpërmjet projekteve kërkimore, konferencave të përbashkëta, shkëmbimeve, dhe të tjera iniciativa, për të pasur një ndikim të plotë në fushën akademike. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Institucioni ka nënshkruar rreth 30 marrëveshje **(Evidenca R.2 a, b, c.1, c.2, d, e, f)** me kompani dhe studiot e reklamave për bashkëpunim dhe për realizimin e praktikës së studentëve në fushën e Dizajnit. Universiteti duhet ta zgjeroj gamën e kompanive vit pas viti, në mënyrë që ti ofroj studentëve mundësi zgjedhje, aq më tepër që numri i studenteve është më i madh.<br><br>Gjithashtu, universiteti duhet të inkurajojë bashkëpunimin me kompani dhe agjenci të huaja që operojnë në Shqipëri, me qëllim që studentët të kenë një përvojë konkuruese në treg. Departamenti duhet të bëhet iniciator i kësaj iniciative. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion | Në dy vitet e fundit, nga viti 2021 deri në 2023, Departamenti i Art Dizajnit ka hartuar raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani dhe studio lokale në fushën e dizajnit. Secili vit ka rreth 30 marrëveshje bashkëpunimi me kompani ose studio të këtij profili, me 30-40 studentë që kryejnë praktikën në vit **(Evidence 1.8. a, b).** |

| | |
|---|---|
| të realizimit të programit të studimit. | *Rekomandohet të lidhen* marrëveshje te reja me studio dhe agjenci reklamash prestigjoze në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të përgatitur studentët për t'i bërë ata më konkurrues në treg, por edhe për të realizuar vizita studimore dhe shkëmbim ekserience. |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka një rrjet bashkepunimi me institucione homologe, por duhet ti riaktivizoj bashëpunimet dhe të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimit me institucione brënda dhe jashtë vendit, për të mundesuar projekte konkrete fushën e dizajnit.*<br>*Gjithashtu, Universiteti duhet të mundësoj shkembime stafi dhe studentesh me Universitete Europiane.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë | Programi i studimit është organizuara në lëndë dhe module, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit parashikon 60 ECTS në vit dhe 180 ECTS në total dhe organizohet në 24 lëndë dhe 28 module. |

| | |
|---|---|
| përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | **(Evidenca H.1, Neni 4 dhe Evidenca 2.1.a, b).** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Objektivat e programit të studimit nuk përcaktojnë qartazi specilitetin e fushës së studimit si dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale që studenti do të përftoj në përfundim të studimeve **(Evidenca H.1).** Programi i studimit ka njëkohësisht dy specializime kryesore dizajn grafik dhe komunikim visual dhe dizajn interieri. Në këto profile nuk janë të qarta objektivat formues, pasi ato janë shumë të përgjithshëme.<br><br>Programet e shkollave perëndimore të Dizajnit kanë si objektiv psh:<br>Njohjenë historisë, teorisë dhe kritikës së Dizajnit dhe impaktin që krijon në praktikat bashkëkohore.<br>Të kuptuarit në kuptimin e plotë të formës dhe funksionit të tipografisë dhe metodologjive për komunikimin me sukses të ideve, koncepteve dhe/ose identiteteve nëpërmjet mediave të ndryshme, etj.<br><br>*Në Rregulloren e Programit të Studimit* ***(Evidenca H.1)*** *sugjerohet të specifikohen fushat e ekspertizës specifike te dizajnit, pasi ne bote ato jane te ndara, dhe po ashtu edhe të punësimit për studentët që kryejnë këtë program.* |

<table>
<tr><td>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</td><td>Në programin e studimit, për çdo lëndë dhe modul është përcaktuar veprimtaria formuese A, B, C, D, E dhe lëndët janë grupuar në module sipas kategorive të tyre me një ngarkesë të përshtatshme në kredite. Kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn është në përputhje të plotë me kriteret e VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar), e cila i ndan lëndët në pesë kategori (A, B, C, D, dhe E).<br><br>
<table>
<tr><th>Kategoria</th><th>Komponenti mësimor</th><th>Kërkesat ligjore:</th><th>Bsc_Diz Kredite</th></tr>
<tr><td>A</td><td>LËNDË BAZË –</td><td>15-20% (kredite)</td><td>(31 kredite) 17 %</td></tr>
<tr><td>B</td><td>LËNDË KARAKTERIZUESE –</td><td>50-55% (kredite)</td><td>98 (kredite) 54%</td></tr>
<tr><td>C</td><td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE –</td><td>12-15% (kredite)</td><td>(24 kredite) 13%</td></tr>
<tr><td>D</td><td>LËNDË PLOTËSUESE –</td><td>10-15% (kredite)</td><td>11 (kredite) 10%</td></tr>
<tr><td>E</td><td>DETYRIME PËRMBYLLËSE (Mikroteza)</td><td>3-5 % (kredite)</td><td>(8 kredite) 4 %</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</td><td>Plani mësimor i programit Bachelor në "Dizajn" ka të përcaktuara kreditet për realizimin e praktikës profesionale (Praktika profesionale - 6 ECTS) dhe për detyrimet e përfundimit të studimeve (Diploma - 8 ECTS) (Evidenca H.1, Neni 6, Neni 8).</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</td><td>“Albanian University” nuk është një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë</td><td>N/A</td></tr>
</table>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Universiteti është në proces për kodifikimin e Programit të "Dizajnit" sipas Udhëzimit të MAS Nr. 31, date 15.11.2022. |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i Studimit Bachelor në "Dizajn" nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaja |
| **Konkluzione** | *Kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn është në përputhje të plotë me kriteret e VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar).*<br>*Kurrikula është në përputhje me kriteret ligjore dhe programi përcakton një ngarkesë të përshtatshme në kredite për lëndë dhe module. Ky strukturim i qartë ndihmon studentët të ndjekin progresin e tyre dhe të planifikojnë studimet e tyre në mënyrë efikase.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | GVJ konstaton se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bsc në "Dizajn" është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, përmban në strukturën e tij 3 **njësi bazë (Departamente):**<br>1. Departamenti i Shkencave Ekonomike;<br>2. Departamenti i Inxhinierive;<br>3. Departamenti i Art Dizajn;<br>Në viti akademik 2022-2023 Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përfshin në strukturën 82 anëtarë si personel akademik nga të cilët 39 anëtarë janë PAE dhe 43 anëtarë janë PAK me kualifikimin e mëposhtëm: |

<table>
<tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Fakulteti i i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>6</td></tr>
<tr><td>Prof.Asoc</td><td>3</td><td>8</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>16</td><td>19</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>19</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>39</td><td>43</td></tr>
</table>

Departamenti i Art Dizajnit, i cili është njësia përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Dizajn", përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe numrin e titujtve dhe gradave të stafit akademik sipas evidencës së paraqitur për periudhën 2019-23 **(Evidenca 1. BSc. Dizajn të dhëna stafi akademik v.a 2022-2023.xlsx) dhe për periudhen 2019-2023; Tabela 1,2,3).**

<table>
<tr><th rowspan="3">Kualifikimi i stafit akademik të</th><th colspan="6">Departamentit i Art Dizajn</th></tr>
<tr><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Dr/Phd</td><td>3</td><td>3</td><td>4</td><td>3</td><td>4</td><td>2</td></tr>
<tr><td>Msc.</td><td>6</td><td>4</td><td>3</td><td>3</td><td>3</td><td>3</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>9</td><td>8</td><td>7</td><td>7</td><td>7</td><td>6</td></tr>
</table>

Po ashtu, edhe nga vizita në institucion dhe takimi me zyrën e burimeve njerëzore, si dhe kontrolli random i dokumentacionit (dosjet e stafit) të zyrës së burimve njerëzore, rezulton se struktura akademike e departamentit përmbush detyrimet ligjore.

*Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK), për njësinë bazë përgjegjëse (DAP), për programin e studimit,Bsc "Dizajn", sipas viteve akademike, paraqiten si më poshtë:*

<table>
<tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik për Programin e Studimit</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2020-2021</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
</table>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>Prof.Dr.</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td><td>0</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr>
<tr><td>Dr./PhD.</td><td>4</td><td>4</td><td>5</td><td>3</td><td>3</td><td>3</td></tr>
<tr><td>MSc.</td><td>4</td><td>3</td><td>3</td><td>3</td><td>6</td><td>4</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>8</td><td>8</td><td>8</td><td>7</td><td>9</td><td>8</td></tr>
</table>
Megjithatë, sugjerohet që CV-të e stafit, përfshirë atij me kohë të plotë dhe të pjesshme, të jenë të përditësuara (duke përfshirë edhe publikime, punime, pjesëmarrje në Konferenca, etj të viteve të fundit) dhe të publikohen online në web site të Universitetit.<br>Në evidencën (Evidenca 4.2), vihet re mungesa e CV-ve të stafit me kohë të plotë në referim të strukturës së Departamentit për vitet 2019-23. Po ashtu një pjesë e madhe e CV është shumë bazike në përmbajtje dhe reflektojnë një nivel të ulët eksperience akademike.
Cv-t e stafit duhet të jenë të uniformuara në një format dhe të përfshinë zëra si eksperience akademike, publikime, artikuj shkencor, ekspozita, projekte dhe pjesëmarrje në Konferenc
Numri i stafit akademik në Departamentin e Art Dizajnit ka ardhur në rënje nga 10 staf akademik i brëndshëm në vitin akademik 2019-20 në 7 staf akademik i brendshëm në vitin akademik vitin 2022-23. Po ashtu edhe stafi akademik i jashtëm është zvogëluar në numër, nga 8 në 2019-20 në 6 në vitin akademik vitin 2022-23 ( Evidenca:Tabela Aneks RVB BSc.Dizajn.pdf, Tabela 1.1, 1.2, 1.3, 1.4).
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</td>
<td>Bazuar në rregulloren e Programit të studimit, departamenti ka përcaktuar angazhimin e personelit ndihmës akademik/administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe ka krijuar mundësi për studentët të kryejnë praktikën profesionale pranë studiove, kompanive apo institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi (Evidenca H.1, Neni 27). Për çdo pedagog është parashikuar që të ketë nën mbikëqyrje 25 studentë (Evidence 2.2).<br>Studentet konfirmojnë se informohen nga Departamenti dhe ndihmohen nga pedagogët për realizimin e praktikave mesimore (gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët dhe alumni).</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit</td>
<td>Në Departamentin e Art Dizajnit, përgjegjesi i Departamentit është edhe përgjegjës për programin e studimit. Programi i Dizajnit ka koordinator Dr. Shpend Bengu (Evidenca 2.4)</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | |
| **Konkluzione** | *Departamenti i Artit të Dizajnit përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, përfshirë numrin e titujve dhe gradave të stafit akademik.*<br>*Megjithate, numri i stafit akademik ka ardhur në rënje vitet e fundit, megjithë rritjen e numrit të studentëve. Kjo ka ndikuar në rritjen e ngarkesës akademike, mungesën e specializimit dhe uljen e cilësisë së mësimdhënjes.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti i Art Dizajnit, si njësia kryesore që ofron Programin e Studimit Bachelor në Dizajn, ka në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturimin dhe përmbajtjen e programeve.<br>Kjo njësi disponon dosjen e programit të studimit, e cila i është vënë në dispozicion grupit të vlerësimit të jashtëm, informacionet e nevojshme në lidhje me elementët e programit të studimit, misionin, objektivat, strategjinë e zhvillimit, lëndët, dhe strukturën e tij të përshkruara në rregulloren përkatëse të programit.<br><br>***Evidenca 2.1.a,b Plani mesimor-kurrikula e programit Bachelor ne Dizajn***<br>***2.2 Rregullore Departamenti***<br>***H.1 Rregullore Programi***<br>***Aneksi 2.6 , 2.6,1, 2 Syllabuset***<br>***Aneksi 4.2 CV-të e Personelit Akademik*** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Plani mësimor i programit Bachelor në Dizajn përmban një listë të lëndëve dhe moduleve të ndara në semestra, duke specifikuar kategorinë e veprimtarisë dhe ngarkesën mësimore për secilën: leksione, seminare, laboratorë, kohën në auditor dhe kohën jashtë auditorit **(Evidenca 2.1.a.b).** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha | Informacionet e nevojshme për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të paraqitura në 'Rregulloren e |

| | |
|---|---|
| informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Regjistrimeve dhe Transferimeve', e cila është miratuar në vitin 2020 **(Evidence 2.5).** Një informacion i përgjithshëm publikohet edhe në web site. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Rregulloret e programit të studimit në Dizajn **(Evidence H.1)** dhe plani mesimor **(Evidence 2.1.a.b)** përfshijnë kurrikulën me të dhënat e ngarkesës mësimore për secilën lëndë. Këto detaje dhe specifikime gjithashtu janë të përshkruara në syllabuset e lëndëve **(Evidence 2.6)** dhe përputhen me regjistrin e lëndëve.<br>***(Sipas vizitës në Institucion dhe evidentimit në Sekretarinë Mësimore).*** |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Ndryshimet e miratuara në programin e Dizajnit në vitin 2021 në linjat e përgjithshme kanë përmirësuar kurrikulën. Megjithatë, në dokumentacionin për rishikimin e programit nuk ka argumente përse këto ndryshime kërkohen dhe në disa raste janë ndryshime që prekin thelbin e lëndës **(Evidenca 2.7).**<br>*(Për shembull, ndryshohet emërtimi i lëndës Kaligrafi në Kaligrafi dhe Tipografi, por thuhet se nuk ndryshon përmbajtja. Kaligrafia eshte shkrimi me dore, ndersa tipografia perfshin shkrimin digjital, dhe mënyra e trajtimit të programit është e ndryshme).* |
| **Konkluzione** | *Departamenti i Art Dizajnit paraqet një burim të pasur informacioni dhe dokumentacioni për programin e Studimit Bachelor në Dizajn, duke theksuar organizimin dhe strukturën e kurrikulës.*<br>*Departamenti duhet ti kushtojë vëmëndje të vecantë dokumentimit të ndryshimeve të kurrikulës për të garantuar transparencë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, | Programi i Studimit Bachelor në Dizajn, në mënyrën se si është i strukturuar përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve, I |

| | |
|---|---|
| shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | formon studentët me njohuri në fushën e dizajnit grafik, ilustrimit artistik dhe dizanit të interierit, por jo me eksperize specifike. Ky program vë bazat për praktikimin e profesionit si dizajner në fushën e komunikimit visual, por duke prekur tangent edhe fushën e dizajnit (apo më mirë dekorimit) të interierit. Megjithatë, lëndët duhet të kenë më shumë fokus në dizajn të aplikuar sipas teknologjive bashkëkohore.<br>Për sa i përket dizajnit të interierit, studentët fitojnë njohuri bazë, mbi dekorimin e interierit të cilat ata duhet t'i thellojnë për të ushtruar profesionin e dizajnerit të interierit **(nga diskutimi me pedagogët e programit gjatë vizitës në Institucion).**<br><br>Ky program studimi përgatit studentët për specializime të ndryshme në fushën e dizajnit, duke përfshirë dizajnin grafik, multimedian, ilustrimin artistik, dizajnin e brendshëm etj. *Megjithatë programi ofron aftësim krysisht në fushën e artit dhe pjesërisht dizajnit grafik. Për të punuar në fushat e tjera duhet të ofrohet mundësi për specializim të mëtejshëm në nivelin e studimeve të larta master.* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Në programin e studimit Bachelor në "Dizajn" ka disa raste kur lëndët ose modulet nuk janë të shpërndara në mënyrë të përshtatshme, duke marrë parasysh formimin gradual të studentit gjatë viteve dhe semestrave. Gjithashtu, nuk janë të paraqitura në mënyrë të plotë njohuritë mbi programet kompjuterike të nevojshme për lëndët **(Evidenca 2.6, 2.6.1, 2.6.2) (Evidenca: 2.1. a.b).**<br><br>Përmbajtja e disa lëndëve parashikon njohuri që nuk përshtaten me nivelin e formimit të studentit ose me objektivat e përcaktuara për programin.<br>Psh. **Lënda "Njohje projekti"**, e cila zhvillohet në vitin e II, në semestrin e parë, paraqet disa aspekte që nuk përputhen me fokusin kryesor të programit të studimit. Për shembull, në përmbajtjen e saj trajtohen projekte urbanistike dhe arkitektonike të mëdha **(Evidenca 2.6.2),** gjë që nuk është në qëndër të objektivave të programit. Kjo lëndë duhet të përqëndrohet në njohuritë bazë të vizatimit dhe projektimit të interierit.<br>Po ashtu, duke marrë parasysh mungesën e lëndëve që lidhen me vizatimin kompjuterik për interierin në 2D (siç është programi AUTOCAD), është e rekomandueshme që, përveç njohurive për projektin e interierit, të integrohen edhe bazat e vizatimit teknik (dorë dhe kompjuterik) si pjesë e kësaj lënde, veçanërisht duke u nisur nga sasia e lartë e kredive (7 ECTS).<br><br>Lënda 'Arti Grafik i botimeve', e cila përdor programin IN DESIGN, është e rekomandueshme të zhvillohet pas lëndës Art 2D/2 që trajton dizajnin me ADOBE INDESIGN. Kjo rekomandohet të zhvillohet në |

| | |
|---|---|
| | vitin e III, pasi studentët do të kenë përvojë dhe njohuri të mjaftueshme për të përdorur me sukses programin IN DESIGN.<br><br>Gjithashtu, lënda 'Interior Dizajn', e cila kërkon njohuri të vizatimit dhe vizualizimit 3D për realizimin e projektit të brendshëm, është e rekomanduar të zhvillohet gjatë vitit të tretë. Kjo do t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë aftësitë e vizatimit 3D në mënyrë paralele.<br><br>Lëndët Grafike (1,2) si lëndë bazë, mund të jepen gjatë vitit të dytë, duke e përcaktuar paralelisht me mësimet e programeve kompjuterike në lëndën Art 2D.<br><br>Për lëndën që kanë një orientim më tepër në art sesa në dizajn, është e rekomandueshme të rishikohen për të pasqyruar më mirë orientimin drejt dizajnit. Emërtimi si "Arti Grafik i botimeve" mund të përditësohet në "Dizajni i botimeve" (Publication Design) për të përshtatur më mirë me terminologjinë ndërkombëtare dhe për të pasqyruar më saktësisht përmbajtjen.<br>1. Lënda "Histori Arti I, II" mund të përfshijë historinë e dizajnit për të pasur një orientim më të përgjithshëm. Një emërtim i përdorshëm mund të jetë "Histori arti dhe Dizajni", duke reflektuar ndryshimet në drejtim të një përqasje më të gjerë në program.<br>2. Lënda Histori Arti III mund të rishikohet në mënyrë që të reflektojë më saktësisht fokusin drejt dizajnit. Një emërtim alternativ mund të jetë "Dizajni Bashkekohor", duke pasur një fokus më të qartë drejt dizajnit moderne dhe bashkëkohor.<br>3. Lënda "Arti Grafik i botimeve" mund të rishikohet në "Dizajni i botimeve" (Publication Design), për të përshtatur më mirë terminologjinë ndërkombëtare dhe për të pasqyruar përkthimin e saktë në shqip.<br>4. Lënda "Art 2D" mund të përmirësohet në "Grafika dixhitale 2D" ose "Dizajn grafik 2D" për të qenë më specifik dhe për të pasqyruar qartësisht përmbajtjen.<br>5. Lënda "Art 3D" mund të rishikohet në "Modelim 3D" për të përshkruar në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme fokusin e lëndës në dizajnin 3D të interierit, mobiljeve dhe objekteve në hapësirë. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Struktura e programit dhe lëndët e ofruara mund të përmirësohet në përputhje me sugjerimet në komentet e Kriterit 2 për të përafruar programin me programe të ngjashme të shkollave ndërkombëtare. Sa i përket raportit teori-praktik, secila lëndë është në përputhje me nevojat e programit të studimit **(Evidenca 2.1. a, b).** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Organizimi i kurrikulës sipas veprimtarive formuese në % të parashikuara nga ligji, si dhe raporti i orëve teorike, seminareve dhe orëve praktike/laboratorit **(Evidenca 2.1. a, b)** janë të ngjashme me programet ndërkombëtare dhe sigurojnë një përgatitje të mirë teorike dhe praktike të studentit për tregun e punës. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Departamenti kryen periodikisht një proces përmirësim të syllabus-eve për ti përshtatur ato me tregun e punës dhe teknologjitë e fundit, por edhe për të përditësuar literaturën **(Evidenca 2.8).** Megjithatë, literatura e propozuar në syllabus vazhdon të jetë e vjetër dhe shpeshherë nuk është e përshtatshme për lëndët. Si pasojë e mungesës së teksteve në fushën e Dizajnit në gjuhën shqipe, pedagogët duhet të përfshijnë leksionet e tyre të bazuar në literaturën bashkëkohore të huaj. Universiteti duhet të stimuloj përkthimin e teksteve bashkëkohore në këte fushë.<br><br>Nga lista e teksteve në bibliotekë (Evidenca 4.7) dhe nga biseda me studentet e programit të studimit, rezulton se shumica e librave janë në dispozicion drejtpërdrejt për lëndët si literaturë detyruese. Megjithatë, disa nga librat e detyrueshëm në syllabus nuk gjenden në bibliotekë. Psh.<br>1. Dominick Joseph, R. (2010) Dinamika e Komunikimit masiv, UET press, literature e detyrueshme e lendes Arti grafik i Botimeve<br>2. Vrioni, Q. (2013) Fjalori i Fotografise, Tirane, Literature e detyrueshme e lëndës Fotografia **(Evidenca 4.7 dhe Evidenca 2.6.2)**<br><br>*Në fushën e Dizajnit, tekstet në gjuhën shqipe mungojnë disi. Për të kompensuar këtë mungesë, departamenti mund të investojë në blerjen e botimeve të huaja në formatin fizik apo digjital, si dhe në abonime për revista të specializuara në interier dhe dizajn grafik. Kjo do të siguronte një gamë më të gjerë të burimeve për studentët dhe pedagogët në fushën e Dizajnit. Gjithashtu, departamenti duhet te integroj ne syllabus tekstet qe studentet akeseojne permes platformes Elia.* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi i studimit është i strukturuar në mënyrë që studenti të marrë njohuri bazë dhe të përgjithshme në vitin e parë të studimeve. Megjithatë, këto njohuri mund të jenë më specifike, si në rastin e Historisë së Dizajnit, që duhet të integrohet në Historinë e Artit, dhe sidomos në Historinë e Dizajnit bashkëkohor.<br>Në dy vitet e vazhdueshme, studentët marrin njohuri më specifike të lidhura drejtpërdrejt me profesionin. Përmbajtja e programit është e përshtatshme, por duhet të ketë një organizim më të mirë të lëndëve në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | raport me periudhat kur ato ofrohen, për të mundësuar vazhdimësinë e dijeve dhe për të lehtësuar procesin e marrjes së njohurive. | | | |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajtja e programit ofron mundësi për punësim të studentëve pas përfundimit të studimeve, por programi duhet të sigurojë një ekspertizë më të mirë, që vlera e studentit të jetë më e lartë në tregun e punës. Ky program ofron mundësinë për studentët për të vazhduar studimet në nivelet e Masterit në fusha të veçanta të dizajnit, si: Master në Dizajn të Brendshëm, Reklamë, Komunikim Vizual, Dizajn Multimedial, dhe të tjera. | | | |
| **Konkluzione** | ***Elementët kritikë të strukturës, organizimit dhe përmbajtjes së programit.***<br>**a.** ***Mungesa e eksperitizës specifike në fushën e dizajnit.*** *Programi fokusohet kryesisht në art dhe pjesërisht në dizajnin grafik, duke lënë hapësirë për përmirësime në aspektin e dizajnit grafik, të interierit dhe teknologjive bashkëkohore.*<br>**b.** ***Literaturë e pa përditesuar me trendet e kohës në këto fusha studimi.*** *Në aspektin e literaturës, mungesa e teksteve në gjuhën shqipe për fushën e Dizajnit kërkon përfshirjen e literaturës bashkëkohore të huaj në mësimet e pedagogëve. Investimi në blerjen e botimeve të huaja dhe abonimet për revista specializuar do të pasurojë burimet për studentët dhe pedagogët.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Në përpjekje për të përmirësuar programin e studimit, Departamenti i Artit të Dizajnit ka krijuar një grup pune për rishikimin e kurrikulës dhe përmbajtjes së syllabuseve. Megjatë ndryshimeve të bëra në program, disa prej tyre nuk janë argumentuar në mënyrë të detajuar, duke lënë pa sqaruar burimin, autorësinë, ose kriteret që kanë qënë nënshtruar për propozimet. Disa nga këto ndryshime kanë pasur impakt pozitiv në përmirësimin e kurrikulës. Megjithatë, propozimet si shtimi i lëndës së Restaurimit nuk janë shoqëruar me një bazë argumentuese të qëndrueshme. Është e rëndësishme që çdo ndryshim në kurrikulë të shoqërohet me një analizë të argumentuar, duke përfshirë rëndësinë dhe nevojën e këtyre ndryshimeve. |

| | |
|---|---|
| | Në bazë të studimit të detajuar të tregut të punës **(Evidenca 2.9),** rezulton që ekspertizat më të kërkuara në fushën e Dizajnit janë: dizajner grafik, ilustrues, fotograf, projektues interieri, kurator, animator, brand dizajner dhe pedagog arti. Nisur nga kjo analizë, kurrikula e Dizajnit mund të plotësohet edhe me lëndë si Animacioni apo Grafika në lëvizje (Motion graphic) dhe Brand Dizajni, që mund të zëvendësojnë lëndë si Restaurimi, që kërkon ekspertizë artistike dhe është lëndë specializimi, dhe Estetika, e cila mund të përfshihet në përmbajtjen e lëndës Historia e Artit (dhe Dizajnit). |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Institucioni nxit dhe mbështet studentët të përfshihen në strukturat vendimmarrëse për të qenë pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve për përmirësimin e programit të studimit, ku përfaqësues të tyre kanë shprehur sugjerime në mbledhjet e departamentit. **(Evidence: Takimi me studentet në Institucion)** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Përmirësimet dhe përditesimet e programit të studimit përmes konsultimeve me aktorë të ndryshëm nuk janë dokumentuar. Gjithashtu, përfshirja e ekspertëve të jashtëm nga bota e biznesit nuk është dokumentuar. |
| **Konkluzione** | Departamenti i Artit të Dizajnit ka ndërmarrë një hap pozitiv duke krijuar një grup pune për rishikimin e kurrikulës dhe përmbajtjes së syllabuseve. Disa ndryshime në program kanë pasuar impakt pozitiv në përmirësimin e kurrikulës, përcjellur nga rezultatet e studimit të tregut të punës. Studentët janë inkurajuar të marrin pjesë në strukturat vendimmarrëse dhe kanë dhënë sugjerime për përmirësimin e programit të studimit.<br>Megjithatë në këtë aspekt ka edhe nje aspekt kritik:<br>***Mungesa e Dokumentimit për Ndryshimet në Kurrikulë lidhur me argumentimin e ndryshimeve:*** *Ndryshimet në programin e studimit nga Departamenti i Artit të Dizajnit nuk janë dokumentuar me arsyetime të detajuara.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Përveç metodave të parashikuara për mësimdhënie në Programin e Studimit Bachelor në "Dizajn", si leksione, seminare, detyra, projekte, praktikat, praktikat profesionale dhe përgatitjen për temën e diplomës, Departamenti i Artit të Dizajnit ka organizuar edhe disa aktivitete me karakter didaktik, si workshope, leksione të hapura, konferenca studentore, vizita në studio, etj. ***(Evidenca: 1.2, a, b, c, d, e dhe bisedat me stafin dhe studentet e programit të studimit, gjatë vizitës në institucion).***<br>*Nga evidencat rezulton që këto aktivitete kane qënë të pakta në numër. Departamenti dhe në vecanti dega, nuk ofron një jetë akademike aktive.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Stafi i Departamentit të Artit të Dizajnit u përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar jo vetëm leksione, por edhe aktivitete alternative akademike si leksione të hapura (pjesa më e madhe e leksionve të hapura gjatë kësaj periudhe kan qenë online) vizita në studio apo kompani, si dhe workshope **(Evidenca: 1.2, a, b, c, d, e).**<br>Nga evidencat rezulton që këto aktivitete janë të kufizuara. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Në fillim të vitit, NJSBC organizon trajnime për stafin akademik me qëllim të përmirësimit të kompetencave didaktike dhe menaxhimit të klasës **(Evidenca 3.1. a, b, c).** Përtej trajnimeve të brëndshme, institucioni duhet të mbështesë pedagogët të përfshihen në trajnime të ndryshme brënda dhe jashtë vendit, në mënyrë që të shkëmbejnë përvojë me kolegë vendas dhe të huaj dhe të përditësohen me metoda të reja të mësimdhënies dhe kompetenca të avancuara. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Nga vlerësimi i studentëve, në pyetësorët mbi procesin mësimor të realizuar 2 herë në vit, rezulton se stafi akademik është në nivelin e pritshmërive të tyre, si në aspektin e përgatitjes mësimore edhe në mënyrën e komunikimit **(Evidenca 3.3 fq.17, 19).**<br>Kjo ishte e qartë edhe nga biseda me studentët, gjatë vizitës në Institucion.<br>Institucioni inkurajon ndërveprimin e pedagogut dhe studentit edhe jashtë orarit të lëndëve përmes platformave të edukimit online si Teams **(Evidence 3.2)**, gjë që i vjen në ndihmë studentit, sidomos për punimin e projekteve të zhvilluara në mënyrë të pavarur, ku ata mund të komunikojnë dhe të shkëmbejnë materiale me pedagogun.<br><br>Nga biseda me studentet gjatë vizitës në Institucion, rezulton se pedagoget janë mjaft të disponueshëm edhe përtej orarit mësimor dhe ka një marredhënje respekti të ndersjelltë mes tyre. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | Njësia përgjegjëse për programin e studimit përfshin studentët në vlerësimin e mësimdhënjes përmes pyetësoreve periodike 2 herë në vit, ku ata vlerësojnë mënyrën e mësimdhënjes **(Evidenca 3.3 fq. 17, 18),** por formulari është i hartuar në mënyrë të tillë që nuk i lejon ata të vlerësojnë metodat e mësimdhënjes apo të shpehin vlerësimin e tyre për metodat e preferuara, apo për të bërë propozimet e tyre. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | NJSBC, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin janë struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e mësimdhënjes **(Evidenca 1.3 Neni. 14, 15, 16),** por jo gjithmonë është efektiv.<br>NjSBC implementon proceset e vlerësimit, siç është organizimi i pyetësorëve të vlerësimit per pedagogët/mësimdhënjen/ lëndëve/ universitetin prej studentëve në fund të çdo semestri. Këto pyetesor, duke qenë shumë të pergjithshem, në nivel universitetit nuk nxjerrin në pah problematika apo elemente që duhet të përmirësohen në programin e studimit, metodat e mësimdhënjes, përmbajtjen e lëndëve apo stafin e Departamentit.<br>Po ashtu, pjesëmarrja e studentëve është mjaft e ulët, rreth 25%.<br>Njesia duhet te inkurajoj pjesmarrjen e studentëve.<br>Evidenca:<br>**1.2 a, b, c, d Raporti Vjetor / Semestral NjSBC**<br>**3.8 Raport vetëvlerësmi**<br>**3.3. a, b, c Rezultatet e pyetësorëve të studentëve**<br><br>NJSBC në bashkepunim me Departamentin duhet të përdor mekanizma të ndryshëm vlerësues dhe përmirësues të cilësisë, si procesi i vlerësimit të kolegëve ("për evaluation") i cili nuk duhet të |

| | |
|---|---|
| | jetë formal, procesi i transparencës së notave, procesi i vetëvlerësimit të secilit anëtar të departamentit, apo vleresimi i studenteve per lendet me synim përmirësimin e vazhdueshëm në mësimdhënie dhe vlerësimin e dijeve. Pyetësorët duhet të rishikohen që të marrë feedback sa më konstruktiv.<br>Vleresohet krijimi i fokus-grupeve per secilin program studimi **(Evidence 6.7, a,b,c,d Rezultatet e focus grupeve).**<br>Po ashtu edhe pyetësori për stafin e Departamentit, ka një pjesëmarrje mjaft të ulët 8%, dhe rezultati nuk mund të konsiderohet i vlefshëm **(Evidence 6.8 Pyetesoret Akademik).**<br><br>Gjatë periudhës së Covid-19, institucioni zhvilloi trajnime për përdorimin e platformës Teams **(Evidence 3.4). Trajnimet duhet te jene te vazhduara dhe metodat e mesimdhenjes te perditesuara.**<br>Pedagoget implementojne vizita ne terren, ne studio, workshope apo ekspozita, por duhet te trajnohen apo te zhvillojne me shume tema aktuale , apo leksione te hapura mbi zhvillimet e fundit ne fushen e dizajnit.<br>Universiteti ka organizuar seanca trajnimi per stafin, por keto aktivitete për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe per te ofruar një game më të gjere metodash mësimdhenje janë të pakta. |
| **Konkluzione** | ***Mungesa e Aktiviteteve Didaktike ekstrakurrikulare:*** *Evidenca tregon që aktivitetet me karakter didaktik, si workshope, leksione të hapura, dhe konferenca studentore, kanë qënë të pakta në numër. Kjo mund te krijoje një mungesë të jetës akademike aktive dhe të limitoj eksperiencat e studneteve në raport me tregun e punës dhe profesionit.*<br>***Mungesa e Pjesëmarrjes së Stafit në Trajnime të Jashtme:*** *Edhe pse ka trajnime për stafin brënda institucionit, mungesa e evidencave për trajnime të jashtme dhe shkembime me kolege nga vendi dhe jashte limitoj perditesimin me metoda dhe kompetenca të avancuara të mësimdhenjes.*<br>***Limitet e formulatit të Vlerësimit nga Studentët:*** *Formulari i përdorur për vleresimin e mësimdhënjes mund të ketë kufizime që pengojnë studentët të shprehin mendimet e tyre më të hollësishme mbi metodat e mësimdhënies dhe të japin propozime konkrete.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Dizajn, është përcaktuar mënyra e vlerësimit të njohurive të studentëve përmes një sistemi kontrolli të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të komponentëve të mëposhtëm: Pjesëmarrja dhe aktivizimi 20%, Provimi i Ndërmjetëm 20% dhe Provimi Final 60% **(Evidenca H 1, Neni 24).**<br><br>Cdo lëndë jep specifikime të hollësishme në syllabus lidhur me organizimin e provimeve dhe kriteret e vlerësimit **(Evidenca 2.6, 1,2),** i cili i bëhet i ditur studenttit ditën e parë të fillimit të kursit.<br>Kjo u evidentua edhe nga procesverbalet e notave në Sekretarinë mësimore si dhe nga bisada me studentët gjatë vizitës në institucion. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Studenti njihet me mënyrën e vlerësimit të dijes përmes syllabusit që i jepet dhe shpjegohen orët e para të mësimit. Gjithashtu, studenti njihet përmes syllabusit edhe me format e testimi, provimi dhe dorëzimit të projektit në varësi të lëndës, si dhe me kriteret e vlerësimit **(Evidenca 2.6 1,2).**<br>Studentët konfirmojnë se janë në dijeni të mënyrave të vlerësimit përmes syllabusit. *(nga biseda me studentet në institucion)* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme, ku vlerësohet jo vetëm rezultati në provime apo dorëzime detyrash/projekte, por edhe pjesëmarrja aktive në klasë në diskutime apo punë praktike **(Evidenca 2.6 1,2).** Studentt dhe pedagoget konfimojne këto menyra testimi. Po ashtu në institucion ka evidenca të projekteve të studentëve.<br>***(nga vizita ne institucion)*** |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Rezultatet e provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare raportohen zakonisht brenda një jave që nga momenti i realizimit.<br>Sistemi elektronik u jep studentëve mundësinë të kontrollojnë notën e tyre.<br>Provimet e korrigjuara dhe vlerësimet e projekteve shoqërohen në komente me gojë. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë t'i shohin provimet e korrigjuara.<br>*Kjo konfirmohet nga stafi, studentet, dhe sekretaria mesimore (gjatë vizitës në institucion).* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të | Institucioni u ofron stafit dhe studentëve postë elektronike për të mundësuar një komunikim të drejtpërdrejtë edhe jashtë orarit të mësimeve. Nga biseda me studentët gjate vizitës në Institucion rezulton se kjo është një nga mënyrat e komunikimit me stafin akademik. Kjo nxit punën e pavarur të studentit, si dhe i jep mundësinë të komunikojë me pedagoget në rast të paqartësive dhe pyetjeve të tyre. |

| | |
|---|---|
| nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Pedagogëti plotësojnë leksionet tradicionale me metoda të tjera si orë praktike në laborator, demonstrime, makete, diskutime në klasë, detyra dhe projekte sfiduese individuale dhe në grupe, prezantime, vizita në galeri apo studio etj. |
| **Konkluzione** | *Sistemi i vleresimit është qartësisht i shprehur në syllabusin e lëndës dhe implementohet në mënyre korrekte.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet përmes një sistemi të vazhdueshëm të kontrollit gjatë semestrit, ku nota përfundimtare rezulton nga kombinimi i komponentëve të mëposhtëm:<br>1. Pjesëmarrja dhe angazhimi 20%,<br>2. Provimi i ndërmjetëm 20%,<br>3. provimi final 60% (Evidenca H 1, Neni 24).<br><br>Kjo dokumentohet edhe në sekretarinë mësimore dhe u pohua edhe nga vetë studentët gjatë vizitës në institucion. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Kontrolli i njohurive mund të bëhet nëpërmjet provimeve me gojë, provimeve me shkrim ose dorezimit të projekteve të kursit.<br><br>*Institucioni nuk vë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike anti-plagjaturë si Turnitin, për kontrollin e detyrave dhe temave të diplomës.* Po ashtu pedagogët nuk përdorin metoda dixhitale për të evituar plagjaturën e projekteve grafike si psh: për identifikimin e imazheve të përdorura më parë në internet, me qëllim të mbajtjes së origjinalitetit dhe parandalimit të plagjiaturave. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Mënyra e vlerësimit dhe pesha specifike e secilit komponent u bëhen të qarta studentëve nëpërmjet sylabusit të lëndës. Kjo mënyre e vleresimit konfirmohet nga studentët dhe procesverbalin në sekretarinë mësimore.<br><br>**Evidenca 2.1.b;** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Studentet marrim komente mbi vlerësimin, por në përgjithësi nga biseda me studentët gjatë vizitës në institucion rezulton se ata nuk kanë patur ankesa në lidhje me vlerësimin.<br>Megjithatë, mbi të gjitha në lëndët me karakter kreativ, pedagogët duhet të japin komente konstruktive në mënyrë për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në bazë të rregullores së Programit të Studimit, personeli akademik siguron zhvillimin korrekt të provimeve duke iu referuar rregullores në lidhje me materialet e ndaluara dhe pasojat e mundshme në rast të shkeljes së saj **(Evidenca H 1, Neni 22).** Studentet janë në dijeni të kësaj rregulloreje.<br>***(Vizita në Institucion)*** |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultati i provimit i jepet studentit brenda 7 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Studentët njihen me rezultatin në mënyrë elektronike përmes sistemit online të quajtur Pitagora. Studentët, konfirmojnë përdorimin e programit Pitagora për marrjen e rezultateve të provimeve në mënyrë elektronike.<br><br>***(Vizita në Institucion)*** |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në bazë të Rregullores së programit të studimit **(Evidenca H.1, Neni 23),** studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit ose të ankimohet për vlerësimin brenda 48 orëve nga momenti kur notat shpallen nga sekretaria në faqen online. Ankimi duhet të depozitohet te sekretaria brenda 48 orëve nga publikimi i rezultateve. Studentet konfirmojne se nuk janë ankimuar për velresimin. Po ashtu nuk insititucioni nuk ka paraqitur asnje procedure / rast kur stuednti është ankimuar. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Sipas Rregullores së programit të studimit **(Evidenca H.1, Neni 23),** pas ankimimit të studentit, Dekani i Fakultetit formon një komision ad hoc, ku përfshihet edhe pedagogu i lëndës. Vendimi për rivlerësim merret brenda një jave nga data e depozitimit të ankesës dhe bëhet i njohur studentit përmes sekretarisë së fakultetit. Vendimi bashkëngjitet procesverbalit të vlerësimit. |
| **Konkluzione** | *Ky program ka një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, imazhin e bizneseve dhe markave, duke plotësuar një nevoje të tregut dhe duke shtuar vlerë në tregun vendas dhe ndërkombëtar. Sistemi i vlerësimit është transparent dhe dokumentohet qartë në rregullore, duke përfshirë pjesëmarrjen, provimin ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar. Studentët kanë mundësi të marrin rezultatet e* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *provimeve përmes një platforme online Pitagora, duke sjellë transparencë dhe lehtësi në shpalljen e notave. Nje aspekt kritik eshte:* ***Mungesa e Sistemeve Elektronike Anti-Plagjiaturë ose mos përdorimi i tyre:*** *Universitetit i mungon një sistem elektronik anti-plagjiaturë si Turnitin për kontrollin e detyrave dhe temave të diplomës. Kjo mund të sjellë rrezikun e plagjiaturës së projekteve dhe imazheve nga interneti.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit, në përputhje me rregulloren e tij **(Evidenca H.1, Neni 4)** dhe strukturën e kurrikulës, siguron një thellim graduale të njohurive. Fillon nga lëndë bazë të përgjithshme dhe vizatime kryesisht me dorë në vitin e parë, vazhdon me lëndë profesionale në vitin e dytë dhe përfundon me lëndë të specializuara që thellojnë njohuritë profesionale në vitin e tretë.<br>Megjithatë, në përmbajtje pesha e lëndëve dixhitale duhet të jetë më e madhe, dhe studentet duhet të nisin që në vit të parë përdorimin e programeve bazë kompiuterike, ndërsa në vitin e dytë të mësojne si të relizojne projekte profesionale, duke ditur tashme si të përdorin programet kompiuterike të fushës. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit garanton kompetenca dhe zhvillimin e aftësive në fushën e dizajnit analog dhe digjital, komunikimit vizual, si dhe shkencave humane. Universiteti mund te ofroj nje game me te gjere te lendeve me zgjedhje në nivel departmenti, fakulteti apo në nivel universiteti. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Rezultatet e të nxënëve paraqiten në fillim të çdo syllabusi **(Evidenca 2.6, 1, 2).** Në përfundim të lëndës, pedagogët bëjnë një raport semestral ku tregohet realizimi i objektivave të mësimit **(Evidenca 3.8).**<br>Ky raport është formal, pasi nuk është i detajuar mjaftueshëm për të kuptuar realizimin e objektivave dhe kompetencat e studentit në përfundim të lëndës.<br><br>*Sugjerohet një analizë më kritike nga ana e pedagogëve.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Programi i Studimit Bachelor në Dizajt ndërthur orët teorike me punë praktike në laborator dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet punën në grup. Disa nga detyrat e kursit parashikohen të punohen në grup në mënyrë që të nxitet diskutimi, komunikim, konfrontimi i ideve dhe zgjidhja e problematikave të projektit nëpërmjet brainstorming për të gjeneruar ide inovative dhe projekte të avancuara. Gjithashtu, insitucioni nxit pjesëmarrjen e studenteve në konferenca studentore dhe ofron mundësi për botim të punimeve të tyre shkencore. Institucioni, gjithashtu mbeshtet mobilitetin dhe shkëmbimin e eksperiencave me insitucione partnere. Këto bashkëpunime kanë mundësuar edhe shkëmbime në kuadër të programeve Erasmus + dhe leksione të hapura me të ftuar nga këto insitucione.<br><br>*Megjithatë, bashkëpunimet dhe shkëmbimet me insitucionet partnere janë të pakta në këtë fushë, dhe për pasojë kanë impakt mjaft të reduktuar. Mobilitetet e studentëve në insitucione partnere janë shumë të rralla.* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Departamenti i Artit të Dizajnit organizon leksione të hapura me specialistë të fushave të dizajnit dhe artit, jashtë orarit të programit të studimit. Kjo mundëson afrimin e studentëve me profesionin e lirë dhe njohjen me problematikat dhe sfidat e tregut të punës **(Evidenca 3.11).** *Megjithatë, leksionet e organizuara këto tre vitet e fundit kanë qenë mjaft te rralla dhe më tepër online* **(Evidenca 3.11).** |
| **Konkluzione** | *Programi integron orë teorike me punë praktike në laborator dhe praktikë profesionale duke ndihmuar studentet të njihen me tregun e punës dhe sfidat aktuale të fushës. Megjithatë vihen re disa aspekte kritike si:*<br>***Mungesa e Leksioneve te Hapura dhe aktiviteteve me profesionist të fushës:*** *Megjithëse ka organizime të leksioneve të hapura dhe punës në grup, duket se frekuenca e tyre ka qënë e reduktuar dhe shpesh online. Kjo mund të ndikoj në aftësinë e studentëve për të njohur thellë profesionin dhe për të zbuluar sfidat e tregut të punës.*<br>***Numer i reduktuar i Bashkëpunimeve dhe Shkëmbimeve aktive me Institucione Partner:*** *Bashkëpunimet dhe shkëmbimet me institucione partner janë të pakta dhe mobilitetet e studentëve shfaqen të rralla. Kjo ndikon në limitimin e përvojës së studentëve gjatë periudhës së studimit dhe mosnjohjene praktikave të mira profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| Standardi III.5<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Rregullorja për provimin përfundimtar dhe punimin e diplomës është e percaktuar në rregulloren e programit të studimit. Brenda një muaji nga fillimi i vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën me dije studentëve të cilët diplomohen atë vit, temat e diplomave. Tema e diplomës përcaktohet nga studenti në bashekpunim me udheheqesin, që miratohet nga Departamenti. Po ashtu tema e diplomës miratohet nga përgjegjësi i departamentit para fillimit të semestrit të dytë.<br><br>Udheheqësi ka detyrim të ndjek studentin gjatë gjithhë periudhës së punimit të diplomës. Vlerësimi përfundimtar i diplomës bëhet pasi student ka kaluar tre kontrolle teë detyrueshme, para një komisioni të posacem për vleresimin e kontrolleve të diplomës të përcaktuar nga Departamenti i Art Dizajn. Komisionet japin vlerësimin verbal dhe përcaktojnë kalimin ose jo në kontrollin pasardhës dhe në mbrojtjen e diplomës. **(Evidenca H.1, Neni 29, 30).**<br><br>*Në rregulloren e programit të studimit, nuk ekziston një prag i notës mesatare që jep të drejtën studentit për punimin e diplomës.* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Në rregulloren e punimit të diplomës, jepen udhëzime specifike për studentët që përfshijnë aplikimin për temën e diplomës, zgjedhjen dhe miratimin e udhëheqësit, tre kontrolle detyruese, dorëzimin dhe procedurën e mbrojtjes. Për çdo hap të këtyre fazave, rregullorja përcakton kërkesat e detajuara që studenti duhet të plotësojë **(Evidenca 3.12).** |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Komisioni i posaçëm për organizimin e provimit final të diplomës nuk teston njohuritë e marra gjatë gjithë viteve akademike, por vlerëson punimin e diplomës të realizuar nga studenti sipas rregullores së Punimit të Diplomës, që përfaqëson sintezën e njohurive të fituara gjatë periudhës së studimit **(Evidenca 3.1).** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon | Udhëheqësi i punimit të diplomes udhëzon dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së punimit **(Evidenca H.1, Neni 29).** Gjithashtu, ai ka detyrë të ndjekë studentin gjatë tërë procesit të punimit të |

| | |
|---|---|
| studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | diplomes. Sipas rregullores së programit të studimit dhe rregullores së diplomës, udhëheqësi nuk është vetëm garantues i cilësisë së rezultateve, pasi miratimi ose jo i punimit pranohet hapat e parë nga një komision i veçantë, i cili ndjek edhe tre konsultime të detyrueshme të studentit **(Evidenca H.1, Neni 29; Evidenca 3.1).**<br><br>*RVB nuk paraqet evidence mbi dokumentimin e procesit të diplomës. Psh. Nuk ka nje raport të udhëheqësit para dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës.* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Departamenti i Artit të Dizajnit ofron laboratorët, stafin dhe ambientet e institucioneve partnere për të mundësuar realizimin e temave të diplomës me sukses. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Provimi përfundimtar i programit Bachelor në Dizajn përfshin një punim diplomë që vlerësohet me notë **(Evidenca 3.13.c).** |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS **(Evidenca 3.13 a, b, c).** Studentëve të interesuar, me kërkesën e tyre, u ofrohet një kopje të plotë të programit të studimit si dhe syllabus-eve të lëndëve. |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Të dhënat e studentit të diplomuar ruhen në sekretarinë mësimore dhe në regjistrat themeltar. Kjo u verifikua me përzgjedhje rastësore të disa studenteve **gjatë vizitës në Institucion.**<br>Kështu, studenti mund të marrë informacion mbi të dhënat e tij në çdo kohë. |
| **Konkluzione** | Procesi i diplomës është i përcaktuar në rregullore për të cilën studentët vihen në dijeni, por institucioni duhet të përmirësojë procesin e dokumentimit dhe vleresimit te diplomës (perfshire oponencen) dhe të sigurojë një përvojë më të mirë për studentët. *RVB nuk paraqet evidence mbi dokumentimin e procesit të diplomës. Psh. Nuk ka nje raport të udhëheqësit para dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Në programin e Studimit Bachelor në Dizajn personeli akademik dhe ndihmës që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për:<br><br>1. Niveli i kualifikimit akademik: Në periudhën 2019-2023, departamenti ka të paktën tre pedagogë me titullin Dr. (Tabela 1, 2).<br>Përveç kësaj, personeli akademik dhe ndihmësi plotësojnë pjesërisht kërkesat ligjore për:<br>a. Drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit: Në periudhën 2019-2023, çdo vit programi mbulohet në masën mbi 70% nga stafi i brëndshëm. Megjithatë, vërehet një disbalancë në shpërndarjen e ngarkesës. Për shembull, në vitin akademik 2020-21, pedagogu Sh. B. ka një ngarkesë totale prej 885 orësh, e cila është rreth 4 herë mbi normën e caktuar nga ligji për kualifikimin Dr. dhe 3 herë më shumë se mesatarja e departamentit **(Evidenca 4.1. a, b, c, d).**<br><br>"Personeli akademik dhe ndihmësi plotësojnë pjesërisht kërkesat ligjore për:<br>a. fushën kërkimore ose përvojën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Për shembull, lënda Kaligrafi dhe Tipografi, e përcaktuar me titullar A. P., zhvillohet nga një arkitekt, jo nga një dizajner grafik. Disa pedagogë si K. T., duke u bazuar në CV, nuk kanë kompetencat |

| | |
|---|---|
| | në fushën kërkimore ose përvojën praktike në arkitekturë, Art 2D, dizajn interier, etj. **(Evidenca 4.2)**<br>Mungojnë evidencat e CV të shumë pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar pranë programit të Dizajnit në vitet 2019-2023.<br><br>Në këtë aspekt, institucioni duhet të punoje për rritjen e cilësisë së stafit akademik në përputhje me profilin e programit të studimit. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke arritur mbi 70% në vit për periudhën 2019-2023. **(Evidenca 4.1. a, b, c, d)** |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Departamenti i Artit Dizajnit, ka ndryshime të stafit akademik. Nga viti akademik 2019-2020 në vitin 2022-23 janë larguar rreth 40 % të stafit brendshëm 4 /10 dhe janë zëvëndesuar me 2 staf të rinj. Po ashtu edhe stafi i jashtë ka në masën 33%, 2 nga 6 pedagog janë larguar dhe në vitin 2022-23 janë zëvendësuar me 4 pedagog të rinj. **(Evidenca tabela 1.1 – 2.4)**<br>Kjo bën që të humbasi memorja dhe njohurite institucionale. Po ashtu, lëvizja e shpeshtë e stafit mund të çojë në ndryshime në standardet e mësimdhënies, metodologjitë dhe praktikat e vlerësimit, duke ndikuar në konsistencën dhe cilësinë e përgjithshme të arsimit.<br>Ndryshimi i vazhdueshëm në stafin akademik mund të pengojë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një kurrikule koherente dhe të mirëstrukturuar. Kjo mungesë e vazhdimësisë së programit mund të ndikojë në përvojën e përgjithshme arsimore për studentët. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Universiteti përcakton kriteret e përgjithshme të zgjedhjes që kandidati konkurrues duhet të plotësojë sipas nevojave të departamentit **(Evidenca 1.7, Neni 19, pika 9).**<br>Thirrja duhet të jetë me e detajuar duke përfshirë profilin e lëndëve dhe fushën e kërkimit.<br>Komisioni i vlerësimit shqyrton kandidaturat (**Evidenca 1.7, Neni 19, Evidenca R.1 a, b, c, d)** dhe i propozon Dekanit kandidatin e zgjedhur sipas renditjes në bazë të kritereve të caktuara. Për kandidatët e zgjedhur nuk ofrohet një përshkrim mbi përputhshmërinë e profilin dhe vlerësimin e kandidatit në përgjithësi.<br><br>*Nga evidenca rezulton se numri i kandidatëve të intervistuar ishte i ulët, mungonte konkurrenca dhe si rrjedhojë, janë zgjedhur dy kandidaturat e paraqitura. Në këtë aspekt, Departamenti duhet të jetë më atraktiv për të terhequr staf akademik të kualifikuar.*<br>**Evidenca 1.7, Neni 19, pika 9;** |

| | |
|---|---|
| | **Evidenca R.1 a, b, c, d;** |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Departamenti i Artit të Dizajnit ka në përmbajtjen e tij edhe staf ndihmës akademik që mbikëqyr mbarëvajtjen e punëve laboratorike dhe kujdeset për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike **(Evidenca: Tabela 1, 2).**<br><br>• gjatë vitit 2020-2021 ka angazhuar 3 personel ndihmës akademik;<br>• gjatë vitit 2021-2022 ka angazhuar 4 personel ndihmës akademik;<br>• gjatë vitit 2022-2023 ka angazhuar 4 personel ndihmës akademik |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Institucioni mbledh, ruaj dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe të personelit ndihmës dhe administrative.<br><br>Zyra e burimve njerëzore disponon dosjen e cdo personelit ndihmës dhe administrativ. Kjo u verifikua gjatë kontrollit random në këtë zyre, gjatë vizitës në institucion.<br><br>*Cv e stafit duhet të përditësohen cdo vit, dhe të publikohen online në web site-in e institucionit*<br><br>**Evidenca: tabela 2, 4;**<br>**Evidenca 4.1;** |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Institucioni vë në dispozicion staf adademik dhe zyrën e karreierës për të asistuar studentët gjate lëndës së praktikës profesionale dhe procesit të diplomës.<br>Në funksion të praktikës profesionale, departamenti cakton për çdo student një udhëheqës akademik nga personeli akademik, i cili mbikqyr studentin përgjatë gjithë procesit, që nga gjetja e një kompanie/institucioni, deri në vlerësimin final të studentit. Gjithashtu, institucioni disponon Zyrën e Karrierës, e cila ndihmon studentët për udhëzimin drejt karrierës dhe për praktikën profesionale. Kjo zyrë ka krijuar marrëveshje me biznese, studio dhe institucione të ndryshme me veprimtari në sektorin e arkitekturës dhe dizajnit, të cilat mundesojnë realizimin e praktikave profesionale për studentët.<br><br>**(Evidenca: 2.6 Sylabuset e lendëve, Praktikë profesionale**<br>**4.4 - Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit)** |

| | |
|---|---|
| | Po Ashtu, në përputhje me rregulloren e projektit të diplomimit, i cakton çdo studenti nga një udhëheqës prej personelit akademik me kohë të plotë, për mbikqyrjen e Tezës së Diplomës.<br>Udhëheqësi i punimit të diplomës udhëzon dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së punimit **(Evidenca H.1, Neni 29).** Gjithashtu, ai ka detyrë të ndjekë studentin gjatë tërë procesit të punimit të diplomës. Sipas rregullores së programit të studimit dhe rregullores së diplomës, udhëheqësi nuk është vetëm garantues i cilësisë së rezultateve, pasi miratimi ose jo i punimit pranohen hapat e parë nga një komision i veçantë, i cili ndjek edhe tre konsultime të detyrueshme të studentit **(Evidenca H.1, Neni 29; Evidenca 3.1, 2.6 Sylabuset e lendëve Teza e Diplomes, 3.12– Rregullore e temes se Diplomes)**<br><br>*RVB nuk paraqet evidence mbi dokumentimin e procesit të diplomës. Psh. Nuk ka një raport të udhëheqësit para dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës.* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Praktika profesionale zhvillohet nën udhëheqjen e një pedagogu të caktuar nga departamenti. Në fund të praktikës, studenti paraqet në departament një raport të miratuar nga udhëheqësi i praktikës pranë institucionit ku kryhet praktika. Ky raport vlerësohet nga një komision që vlerëson punën e praktikës **(Evidenca H.1, Neni 27).**<br><br>Procesi i dokumentuar është formal **(Evidenca 6),** jo deskriptiv të punës së mirefillte që studenti zhvillon gjatë intershipit. Kjo është shume e rendesishme për të kuptuar kontributin e studentit dhe perfitimet e tij nga intershipi. Ky aspekt duhet të dokumentohet më mirë. |
| **Konkluzione** | Institucioni përmbush kërkesat ligjore për numrin e pedagogëve me titullin Dr. dhe ka dokumentacion të rregullt mbi personelin e angazhuar në programin e studimit. Gjithashtu, institucioni vë në dispozicion staf ndihmës që mbikëqyr punët laboratorike dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike tregon përkushtim ndaj sigurimit të resurseve të nevojshme për studentët.<br>Megjithatë, nga pikpamja cilesisë vihen re disa aspekte kritike:<br><br>**Mungesa e konsistences së Stafit Akademik:** Ndërrimet e shpeshta në stafin akademik mund të çojnë në humbje të njohurive institucionale dhe ndryshime në standartet dhe metodologjitë e mësimdhënies. Kjo mund të ndikojë në cilësinë dhe konsistencën e programit të studimit.<br><br>**Përmirësimi i procesit të Rekrutimit, rritja e konkurencës dhe cilësisë së stafit të rekrutuar:** Procesi i rekrutimit nuk ka konkurrencë të mjaftueshme. Numri i kandidateve të intervistuar është ulët, duke |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | sjellë uljene e cilesise se te rekrutuarve. Universiteti duhet të krijoj politika për përthithjen e stafit të kualifikuar.<br><br>**Mungesa e Dokumentacionit për Praktikat dhe Internship:** Mungesa e dokumentacionit për procesin e internshipit dhe praktikës profesionale bën që te mos jetë e qartë lidhja midis teorisë dhe praktikës në programin e studimit. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | **X** | | |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Institucioni siguron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.<br>Albanian University garanton infrastrukturën bazë për realizimin e programit te studimit ne Dizajn. Infrastruktura në përgjithësi lejon për një mbarëvajtje normale të aktivitetit mësimor. Institucioni vë në dispozicion të studentëve klasa, salla leksioni, salla kompjuteri, atelier, bibliotekë. Mjediset mësimore janë të përshtatshme për zhvillimin e metodave të mësimdhënies, edhe pse jo të gjitha kanë akses për personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha këto zona janë të mobiluara dhe të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme teknike. Zyrat per personelin akademik dhe kerkimor jane mjaft te kufizuara ne numer dhe siperfaqe. Në projektin arkitektonik, mungon certificata për mbrojtjen nga zjarri **(Evidenca: 4.6 Planimetria e godines se Rr. se Kavajes.pdf).** Institucioni duhet të garantojë shkallë emergjence dhe mbrojtje nga zjarri. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Të gjitha sallat janë të pajisura me: tavolina, karrige, tabela, dhe kompjuter dhe videoprojektor duke garantuar që mesimdhënje të zhvillohet në kushte të favorshme.<br>Gjithashtu, e gjithë godina është e mbuluar nga një rrjet interneti wireless, i cili është i disponueshëm për të gjithë. **(nga vizita në institucion)**<br>Në vlerësimin e studenteve, Rrjeti wireless, nuk është në cilësinë e pritshme **(Evidenca 3.3. d).** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera janë në përputhje me natyrën e programit të studimit në Dizajn. Më ekzaktësisht ambjentet që universiteti ofron janë:<br>1. Laboratorët e Informatikës 1-2, me kapacitet për 22/24 persona, janë të pajisur me programe grafike 2D dhe 3D, si dhe me programe animacioni si Autocad, Photoshop, Illustrator, Corel Draw, in Design, 3Ds MAX, që përshtaten me natyrën e programit të studimit në Dizajn. Këto laboratorë janë rinovuar me kompjuterë të rinj, me parametra më të mirë dhe programe të përditësuara **(Evidenca 1.6 dhe vizita në institucion).**<br>2. Sallat praktike 1, 2, 3 duhet të përdoret për lëndët praktike të vizatimit, pikturave monumentale dhe grafike. Këto salla janë të ngjashme dhe kanë hapësira pune dhe mjete si: kavaleta, tavolina të mëdha, pajisje për prinime grafike, modele për pikturë dhe vizatim etj. **(Evidenca 1.6 dhe vizita në institucion).**<br>3. Rekomandohet që lënda e Grafikës të jetë edhe në laboratorët e Informatikës, pasi pjesa më e madhe e kësaj lënde duhet të lidhet me grafikën e dixhitale.<br>4. Sugjerohet që Departamenti të sigurojë edhe laborator dhe hapësira pune për printimin dhe prodhimin. Ato duhet të përmbajnë printera për metoda të ndryshme printimi (inkjet, lazer, etj.), prerëse letre, makina lidhëse dhe mjete të tjera të përdorura në prodhimin e dizajneve fizike. Po ashtu, universiteti duhet te investoj një laboratorët e imazheve dixhitale, të pajisur, kamera me cilësi të lartë dhe softuer për manipulimin e imazhit dhe fotografimin dixhital, duke i lejuar studentët të punojnë dhe të modifikojnë elemente vizuale për lëndë si Multimedia dhe Fotografi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Institucioni ofron dy laboratorë të informatikës, të pajisur me programe grafike 2D dhe 3D, si dhe programe animacioni, për tju përgjigjur natyrës së programit të **studimit (Evidenca 1.6).**<br><br>*Sugjerohet që Departamenti të krijoj edhe nje laborator për printimin dhe prodhimin e modeleve si dhe laborator për krijimin e imazheve dixhitale.* |
| **Konkluzione** | Institucioni siguron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, por pas 11 vite experience duhet të ofroj laboratore për printimin dhe prodhimin. Gjithashtu insitucioni duhet të ketë certifikimin për mbrojtjen nga zjarri dhe akses gjithëpërfshiresh në të gjithë ambjentet e tij. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.3**<br>**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Literatura bazë në gjuhën e programit të studimit, pergjithesisht gjendet pranë bibliotekës **(Evidenca 2.6).** Megjithatë, për shkak se fusha e dizajnit është në zhvillim të shpejtë, literatura mbetet e papërditesuar me trendet e reja.<br>Ndërkaq, literatura ndihmëse, në gjuhë të huaj nuk gjendet gjithmonë në bibliotekën e Universitetit **(Evidenca 2.6, Evidenca 4.8).**<br>*Sugjerohet përditësimi i literaturës, me tekste të huaja, të paktën në lëndët specifike të dizajnit, ku edhe përmbajtja është me vizuale, sesa teorike.* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Njësia bazë bën kërkesa për përditësimin e literaturës me botime të reja **(Evidenca 7),** por numri i vëllimeve të përditësuara është mjaft i vogel dhe tekstet është pse janë të viteve 20, nuk mund të konsiderohen tekste të updatuara për këtë fushë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Studentët e Departamentit të Art Dizajnit kanë në dispozicion në godinën e tyre një ambjent të veçantë që është biblioteka mësimore, me tekste të fushës, terminale të lidhura me kompjuterin qëndror dhe ambiente studimi. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ofron për studentët 125 tituj librash në fushën e artit, dizajnit, arkitekturës, historisë së artit dhe fushave të ngjashme (Evidenca 4.8). Rreth 80% e literaturës së detyrueshme në gjuhën shqipe, e cila është prezantuar në syllabuset e lëndëve, gjendet në bibliotekë. Megjithatë, për shkak të kufizimeve dhe literaturës të vjetër në gjuhën shqipe, sugjerohet që biblioteka të pasurohet me tekste në gjuhën angleze në fushën e dizajnit.<br>Universiteti ka abonime në disa faqe revistash shkencore online **(Evidenca R.3, b).** Studentet janë në dijeni të kësaj platforme, por nuk e kanë përdorur (nga biseda me studentët gjatë vizitës në institucion). |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online | Universiteti ka abonime në disa faqe revistash shkencore online **(Evidenca R.3, b),** por nuk ka mjaftueshëm ndërgjegjësim tek studentët dhe stafi për rëndesinë e përdorimit të këtyre platformave. Literatura që këto platfoma ofrojnë duhet të integrohen në syllabuset e lëndëve. |

| | |
|---|---|
| të fushës së programit të studimit. | Vitin e fundit, Departamenti është bërë anëtar i rrjetit ELIA, është një platformë për shkëmbimin e fundit dhe zhvillimin në fushën e artit dhe dizajnit të grafikut.<br>Biblioteka mund të përplotësohet edhe me botime të huaja në fushën e dizajnit grafik. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura me një kompjuter qëndror, të cilat janë vendosur në dispozicion të studentëve duke u mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librave online **(Tabela 17).** |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë, nga e hënë në të premte, nga ora 8:00 deri në ora 12:00. Kjo është deklaruar zyrtarisht dhe është pohuar edhe nga studentët (gjatë vizitës në institucion).<br><br>Kapaciteti i bibliotekës dhe hapësirat e dedikuara për studentët duhet të rriten, nisur edhe nga numri i studentëve në rritje si dhe nga natyra e studimit të tyre, që ka të bëj me përdorimin e laptopave personal, si dhe hapësirave për vizatim. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Nuk ka evidence se departamenti është në kontakt me bibliotekën për të njohur me shfrytezimin e fondit të saj nga studentet dhe stafi. Në të njëjtën mënyrë, nuk ka evidence apo raportim periodik nga ana e bibliotekës së departamentit për veçoritë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin e tyre, të shkallëzuara të përcaktuara nga personeli akademik dhe studenti, siç është e nevojshme të studimit, karakteristikat për tituj si dhe për performancën e personelit akademik. |
| **Konkluzione** | *Biblioteka e Fakultetit ofron një numër të konsiderueshëm të titujve librash në fushën e artit, dizajnit, arkitekturës, historisë së artit dhe fushave të ngjashme si dhe ofron ambjente studimi dhe terminale të lidhura me internet dhe kompjuter që mundësojnë studentëve kërkim në internet dhe aksesimin e librave online.* |

| | |
|---|---|
| | ***Mëgjithate, u vun re edhe disa aspekte kritike:***<br><br>***Mungesa e Përditësimit të Literaturës:*** *Literatura bazë në fushën e dizajnit nuk është përditësuar me trendet e reja, duke pasuar një zhvillim të shpejtë në këtë fushë. Tekstet e reja që blihen nga biblioteka jane te pakta dhe jo te viteve te fundit. Kjo mund të rezultojë në mungesë të njohurive të fundit për studentët dhe ndikimin e tyre në praktikën profesionale. Përditësimi me tekste të huaja në lëndët specifike të dizajnit, ku vizualja ka rëndësi, nuk është i mjaftueshëm. Ky aspekt sugjeron nevojën për përmirësime në përditësimin dhe pasurimin e literaturës në gjuhën angleze.*<br><br>***Mungesa e Ndërgjegjësimit për Burimet Online:***<br><br>*Edhe pse universiteti ka abonime në faqe revistash shkencore online dhe rrjetin ELIA, mungon ndërgjegjësimi tek studentët dhe stafi për rëndësinë e përdorimit të këtyre burimeve. Përfitimet e këtyre platformave duhet të integrohen në syllabuset e lëndëve* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të studentëve nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi. Të gjitha të dhënat e sekretarisë janë të aksesueshme online nëpërmjet sistemit Pitagora (http:/au.pitagora.rash.al/). Çdo student ka llogarinë e tij, ku mund të identifikohet me kredencialet e veta dhe të marrë informacion lidhur me të dhënat e tij të përditësuara, lëndët që duhet të frekuentojë, rezultatet e provimeve, etj.<br>Kjo është verifikuar gjatë vizitës në institucion dhe është pohuar edhe nga vetë studentët.<br><br>**Vizita në institucion;** |







| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit ruhen në Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në programin e studimit ruhen në Departament dhe në Zyrat përkatëse: Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi i menaxhimit online siguron akses për studentët për të marrë informacion në lidhje me të dhënat e tyre të përditësuara, lëndët që duhet të frekuentojnë, rezultatet e provimeve, etj. (Nga biseda me studentë, dhe verifikimi në Sekretarinë mësimore online, gjatë vizitës në institucion)<br>*Sistemi i menaxhimit online gjithashtu siguron akses për personelin.*<br><br>**Vizita në institucion;** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Stafi akademik, administrativ dhe studentët disponojnë adresat e postës elektronike të institucionit, të cilat ofrohen përmes paketës Office 365. Kjo platformë mundëson ruajtjen, ndarjen e informacionit dhe komunikimin në kohë reale ndërmjet përdoruesve.<br><br>**Vizita në institucion;** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Stafi akademik, administrativ dhe studentët disponojnë adresat e postës elektronike të institucionit që ofrohet përmes paketës Office 365, e cila mundëson ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe komunikimin në kohë reale ndërmjet përdoruesve. Kjo shërben edhe për komunikimin dhe raportimet në kohë reale me organet dhe autoritetet drejtuese. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Në faqen e internetit të institucionit 'Albanian University' (https://albanianuniversity.edu.al/sq/), jepen informacione lidhur me programin e studimit Bachelor në Dizajn. Faqja ofron informacion mbi stafin e Departamentit që ofron këtë program, si dhe aktivitetet e tyre të ndryshme, të përditësuara.<br>Megjithatë mungon një bio e stafit të programit, me eksperiencën akademike, kërkimore, botimet e konferencat per secilin staf akademik.<br><br>*Faqja e internetit të Universitetit është e disponueshme në gjuhën angleze dhe shqipe.* |

| | |
|---|---|
| **Konkluzione** | ***Sistemi i Menaxhimit Online dhe Transparenca për Studentet:*** *Sekretaria mesimore ka nje sistem te avancuar te menaxhimit online, i cili siguron akses te studenteve per te shikuar dhe monitoruar informacionin e tyre. Kjo është një pike pozitive që rrit transparencën dhe lehtëson aksesin e studentëve në të dhëna të tyre akademike.*<br><br>***Ruajtja e Informacionit dhe Ndërveprimi Online:*** *Ruajtja e të dhënave për personelin akademik, administrativ dhe partnerët është e rëndësishme dhe është nje praktikë e mirë. Ndërveprimi online dhe përdorimi i adresave të postës elektronike ofrojnë një mënyrë efikase të komunikimit dhe bashkëpunimit në kohë reale.*<br><br>***Disponueshmëria e Faqes së Internetit në Dy Gjuhë:*** *Disponueshmëria e faqes së internetit në dy gjuhë, shqip dhe angleze, është një aspekt pozitiv që i shërben diversitetit të studentëve dhe përdoruesve të faqes.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Institucioni harton një raport financiar vjetor dhe një raport financiar 3-vjeçar, në bazë të nevojave të propozuara nga njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.<br>Pas hartimit të buxhetit, ai kalon në Rektorat për miratim, pastaj kalon në Senatin Akademik për miratim dhe në fund i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet | Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit nuk rezulton te përmbaje financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, si investime per laboratorin e informatikes, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, shpenzim për kërkim shkencor, apo fond per departamentin ( **Evidenca 6).**<br>Plani i financimit lidhet kryesiht me shpenzime per pagat e stafit dhe aktivitete shkencore. |

| | |
|---|---|
| për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Në 'Albanian University', është ngritur dhe operon Zyra e Auditit të Brendshëm, e cila merret me kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të Zyrave të Financave dhe Auditit të Brendshëm.<br>Institucioni kryen gjithashtu auditim të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabel i miratuar, i cili zbatohet mbi bilancin e çdo viti dhe përmban një raport të detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve.<br>Këto raporte analizojnë efikasitetin e ardhur nga tarifat e studimit dhe raportohen periodikisht pranë Bordit të Administrimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Pas kësaj faze, realizohet një analizë e cila planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për të përmirësuar mbarëvajtjen e programit të studimit. Per kete nuk paraqitet asnje evidence. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Institucioni deklaron se situata financiare dhe bankare është e qëndrueshme gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, dhe disponon kapacitet financiar të mjaftueshëm për përmirësimin e vazhdueshëm dhe për të gjeneruar të ardhura në të ardhmen. Institucioni duhet te parashikoj nje fond per departamentin, per kerkimin shkencor, si dhe investim te vazhduar ne biblioteke, infrastructure dhe pajisje bashkëkohore për degën. |
| **Konkluzione** | Institucioni deklaron se situata financiare dhe bankare është e qëndrueshme gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, dhe disponon kapacitet financiar të mjaftueshëm për përmirësimin e vazhdueshëm dhe për të gjeneruar të ardhura në të ardhmen, por plan buxhet mbulon kresisht pagat e pedagogeve dhe ne menyre te limituar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | aktivitetet kerkimore. Ky plan buxhetor nuk lejon qe departamentet te kene nje buxhet dhe te programojne investimin ne infrastrukture, pajisje te reja, tekste mesimore, aktivitete shkencore, botime, apo kerkim shkencor. Në këtë aspekt, shihet e nevojshme që universiteti të investoj edhe në këtë drejtim, për të rritur standartin e deges. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | **X** | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Politikat dhe procedurat e hartuara dhe zbatuara nga institucionet kanë sigurojnë barazi dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët.<br><br>Albanian Unviersity në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit, Rregullores dhe akteve të tjera ligjore ka hartuar kriteret bazë dhe kuotat për pranimin e studentëve në universitet, bazuar në kapacitetet infrastrukturore dhe akademike që departamenti ofrues ka në dispozicion. MAS konfirmon kuotat e AU-së përmes nje komunikimi zyrtar çdo vit akademik ku përcaktohen kuotat për çdo program studimi.<br><br>Maturantët informohen rreth programeve të AU me anë të aktiviteteve si takimet ne ambjentet e universitetit, si dhe pjesmarrje ne panaire e ndryshme.<br><br>Aplikimi dhe regjistrimi i maturantëve kryhet përmes tre raundeve sipas kalendarit të përcaktuar nga MAS dhe Institucionet në varësi të saj. |

| | |
|---|---|
| | Listat fituese ngarkohen në portalin U-Albania në bazë të datave të percaktuara në kalendarin e shpallur nga RASHi Pas përfundimit të raundit të aplikimeve, fillojnë raundet e regjistrimit, në përputhje me kalendarin e publikuar nga RASHi. Çdo student që është pranuar pajiset me numër matrikulimi nga QSHA dhe do të konsiderohet student me të drejtat dhe detyrimet sipas rregulloreve përkatëse.<br><br>***(Evidenca 2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve dhe biseda me studentët gjatë vizitës në institucion)*** |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Politikat dhe procedurat e hartuara nga institucioni mundësojnë ndjekjen e drejtë të studentit nga aplikimi, regjistrimi, deri në diplomim.<br>Rregullorja e programit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi dhe deri në përfundimin e studimeve apo transferimeve të tyre, gjë që garanton politikat dhe procedurat transparente për trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët. Në bazë të ligjit të Arsimit të Lartë AU ka marrë masat për ngritjen e Këshillit të Etikës në rang universiteti i cili ka si qëllim respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në rregulloren e kodit të etikës për studentët dhe stafin e institucionit.<br><br>***Evidence: 6.11 - Kodi i Etikes*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Departamenti i Art Dizajnit ka përcaktuar dhe publikuar kriteret e pranimit të aplikantëve studentë në portalin e Maturës Shtetërore. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 435, datë 03.06.2020, pika 3, aplikantët janë përjashtuar nga detyrimi për të plotësuar notën mesatare prej 70%. Gjithashtu, masatarja e grup-lëndëve është përcaktuar të jetë 30%<br>• Histori arti 10%<br>• TIK 10%<br>• Vizatim teknik/ teknologji 10%<br><br>Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe janë pajisur me (Evidenca H1, Neni 10, pika 2):<br>• dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij nivelit të arsimit<br>• nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-e publike dhe jo publike<br>• plotësojnë kriterin e notës mesatare të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave<br>• plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programin e studimit për të cilin aplikojnë. |

| | |
|---|---|
| | Në programet e ciklit të parë mund të regjistrohen edhe studentë të huaj, por për proceduarat dhe dokumentacionin nuk ka një procedure të qartë të deklaruar, e aq me tepër procedurat nuk janë të publikuara online në web site. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit gjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë të përfshira në rregulloren mesimore të programit të studimit **(Evidence H.1, Neni 10, Kreu V).**<br>Kriteret dhe procedurat për transferim, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, janë të përfshira në Rregulloren e regjistrimit dhe transferimeve. Këto materiale bëhen të disponueshme për studentët nga strukturat përkatëse si dhe ne web site te universitetit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore-e-regjistrimeve-dhe-transferimeve/). |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Institucioni fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MASH **(Evidence 5.1, a)** dhe panairit Work and Study (Evidence 5.2, b). Maturantët informohen përmes broshurave, manifesteve akademike dhe udhëzuesve, si dhe orientuesve për maturën **(Evidence 5.2 a, b).** Maturantët e interesuar informohen drejtpërdrejt për përmbajtjen e programit të studimit në mënyrë të detajuar. |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Nuk ka ndonje evidence qe institucioni harton dhe publikon para fillimit të çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. Nuk ka evidence të vendimeve të senatit për miratimin e këtyre kuotave.<br><br>Megjithatë univesiteti, deklaron se ka politika të tilla. |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Nuk ka evidence që institucioni harton dhe publikon para fillimit të çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera. Këto kritere miratohen nga Senati Akademik dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit, duke informuar gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). Aktualisht nuk ka informacion në lidhje me numrin e kuotave të caktuara.<br><br>Megjithate univesiteti, deklaron se ka politika të tilla. |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Me propozim të Senatit Akademik dhe miratimin e Bordit të Administrimit, janë përcaktuar kategorite e studentëve.<br>https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/<br><br>Institucioni nuk përcakton kuota të qarta. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Me propozim të Senatit Akademik dhe miratimin e Bordit të Administrimit, janë përcaktuar kategoritë e studentëve. Informacioni në lidhje me politikat dhe kriteret për bursa në faqen zyrtare të institucionit në linkun: https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/. Megjithatë, institucioni nuk ka percaktuar kuota të qarta për bursat. | | | |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka përcaktuar kriteret e pranimit për studentët nga Matura Shtetërore dhe ka publikuar këto kritere. Po ashtu, procedurat për transferim, njohjen e studimeve të mëparshme dhe të pjesshme janë të përfshira në rregulloren e regjistrimit dhe transferimeve, e cila është e disponueshme online për studentët. Institucioni ka një praktikë të mirë për informimin e maturantëve në ditët e informimit dhe panairin Work and Study përmes broshurave, manifesteve akademike dhe udhëzuesve.*<br>*Pika kritike, në këtë aspekt qëndron në mungesën e dokumentacionit të qartë dhe evidencave konkrete, gjë që i bën deklaratat dhe politikat të jenë të paqarta dhe të pasigurta për publikun dhe aplikantët. Institutacioni duhet të sigurojë dokumente të hollësishme dhe transparente për të mbështetur dhe konfirmuar kuotat e deklaruara.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve, si dhe procesin e kalimit nga një vit akademik në tjetrin **(Evidence H.1, Neni 25).** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve **(Evidence 2.5, Neni 3)**, e cila është përgjegjëse për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin, njeh studentët me procedurat përkatëse për njohjen e kredive dhe transferimin e studimeve. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Studentet informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit që javën e parë të studimeve, në ditët orientuese **(Evidenca 5.2.c)** gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrative, Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes së Studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që lidhen me mbarëvajtjen e studimeve të tyre, si kalendari akademik, orari mesimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mesimore etj. Gjatë orëve të para të mësimit pedagoget njohin studentet me syllabusin e lëndës përmes të cilit studentët njihen edhe me formën e vleresimit.<br><br>***(Evidenca H.1, Neni 24; Evidenca 2.6 a, b)*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në rregulloren e programit të studimit ka informacion edhe mbi kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit **(Evidenca H.1, Neni 28, 29)**. Në fillim të vitit akademik, sipas RVB, Përgjegjesi i Departamentit u bën të njohur studentëve të cilët diplomohet në atë vit, temat e diplomave dhe të gjithë informacionin që nga përzgjedhja e temës dhe caktimi i udheheqësit, kontrollet e detyrueshme pra kominionit të Diplomimit, kriteret e punimit të diplomës deri në mbrojtjen e diplomës. Diploma eshte me projekt dhe teme te shkruar. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Institucioni fillon informimin e maturanteve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MAS **(Evidence 5.2)** dhe më pas jep informacione më të detajuara për kandidatët e interesuar mbi përmbajtjen e programeve specifike apo kriteret e pranimit.<br>AU merr pjese në panairet e organizuara nga dhoma e tregtisë në qytetet e Shqipërisë i japin mundësine te promovojë dhe informoje studentët kandidatë rreth programeve qe ofron dhe eventeve të ndryshme që i organizon. Po ashtu, mirepret here pas here studentët kandidatë ne ambjentet e te dyja godivane duke i informuar mbi programet që ofron. |
| **Konkluzione** | *Përkundër pretendimeve në rregullore, nga takimi me studentët, rezulton se ata nuk janë ende informuar mbi procedurat e përzgjedhjes së temës së diplomës dhe procedurat e diplomimit. Kjo moskuptim mund të shkaktojë vonesa dhe moskënaqësi tek studentët, si dhe të ndikojë në përgatitjen e tyre për këtë fazë të rëndësishme të studimeve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| |
|---|
| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentet informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, qoftë duke vënë në dispozicion rregulloren e programit të studimit, qoftë gjatë javës orientuese, në fillim të vitit akademik, ku Zyra e Koordinimit dhe mbështetjes për Studentët dhe Këshilli Studentor është në dispozicion të studentëve për ti informuar mbi procedurat e ndryshme që lidhen me mbarëvajtjen e studimieve të tyre. | | | |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, nëpërmjet pedagogëve të lendeve, ku secili në fillim të cdo semestri i njeh stuedntet me përmbajtjen e syllabuseve ku shpjegohet përmbajtja e lëndës, mënyra e organizimit, mënyra e vlerësimit, detyrimi i frekuencës, si dhe literatura e detyruar dhe e rekomanduar. **(Evidence 2.6)** | | | |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Institucioni përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët **(Evidence 5.3)** dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit **(Evidence 5.4)** informon studentet vazhdimisht mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete orientuese dhe këshilluese, mbështet studentet në aplikimet e tyre, si dhe mundëson punësimin e studentëve në kompani me të cilat ka marreveshje bashkëpunimi. | | | |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentët marrin informacion mbi procesin mësimor, orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare si dhe mbi ambjentet dhe logjistikën nëpërmjet sekretarisë dhe online nëpërmjet njoftimeve me email. | | | |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Informacion mbi procesin mesimor, orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare si dhe mbi ambjentet dhe logjistikën realizohet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm, në distancë, online dhe nëpërmjet njoftimeve me email. | | | |
| **Konkluzione** | *Përmes përpjekjeve të vazhdueshme për të nxitur transparencën, ofrimin e informacionit të hollësishëm dhe mbështetjen në karrierë, institucioni mund të përmirësojë eksperiencën e studentëve dhe të krijojë një mjedis më përgjegjshëm dhe mbështetës për ta.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Institucioni ka rekorde të përvitshme mbi numrin e studenteve të diplomuar në progrmin Bachelor në Dizajn.<br><br>**Evidenca: Tabela 23;**<br>**Vizita në institucion;** |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.<br>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program për tre vite akademike është si më poshtë vijon:<br>Viti akademik 2020-2021 24 studentë;<br>Viti akademik 2021-2022 18 studentë;<br>Viti akademik 2022-2023 23 studentë;<br><br>***(Tabela 21, 23)*** |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga sekretaria mesimore. Sistemi i manaxhimit është i sigurt dhe lehtësisht i verifikueshme nga personat e autorizuar (***verifikimi gjatë takimit me përfaqesues të sekretarisë mësimore, gjatë vizitës në institucion).*** |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet | Institucioni ushtron kontrolle peiodike pranë njësive përgjegjëse të menaxhimit.<br>1. Rektorati ushtron kontrolle tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e unviersitetit (Evidence 1.4, Neni 5)<br>2. Zyrës së Auditit dhe Kontrollit të Brendshëm (Evidence 1.3, Neni 80)<br>3. Kryesekretari në përfundim të cdo semestri, përgatit një raport mbi realizimin e detyrave për Dekanin e Fakultetit dhe Rektorin. (Evidenca: Rregullorja e Sekretarise Mesimore)<br>(nga takimet gjate vizites ne institucion) |

| | |
|---|---|
| me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Njësia baze në menyre periodike harton raporte mbi cilesine në hyrje dhe dalje të studenteve si dhe shkallën e punësimit të tyre. *(Evidence nga takimi me zyren e karrieres)*<br><br>Gjithashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumnit si dhe janë të përfshirë në procesin e krijimit të raporteve të ndryshme mbi profilet e studentëve të ardhur dhe aktualë dhe shkallën e punësimit të tyre. Te dhenat mbi shkallen e punesimit, jane te pjesshme, pasi nje pjese e studenteve shkepusim marredhenjen me universitetin dhe zyra e Karrieres dhe Alumni e ka te veshtire ti kontaktoj.<br><br>*(Evidenca 5.10 Statistika te punesimit te studenteve, dhe nga biseda me perfaqesues te yzres se Karrieres dhe Alumni, gjate vizites ne Institucion)* |
| **Konkluzione** | Institucioni ka ngritur një sistem të përhershëm të monitorimit dhe kontrollit, duke përfshirë raportim nga njesia baze dhe Zyra e Karrierës. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së programit dhe në adresimin e çështjeve të mundshme në përparimin dhe suksesin e studentëve. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Studentet përfshihen në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të universitetit nëpërmjet përfaqësisë studentore **(Evidence 5.6).** Përfaqësia studentore merr pjesë në mbledhjet e senatit dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit **(Evidence H.2).** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin | Studentët shpehin mendimet dhe kërkesat e tyre nëpërmjet përfaqësisë studentore. Kryetari i këshillit studentor është pjesë e Senatit akademik. ***(Evidence 1.3, Neni 19 dhe takimi me studentet gjate vizites ne institucion)*** |

| | |
|---|---|
| akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Rishikimi i kurrikulave të programit Bachelor në Dizajn në 2021 eshte bere si rezultati edhe I konsuktimeve ne studentet **(Evidenca 2).** Përfaqësues të studenteve marrin pjesë në takimet për rishikimin e kurrikules, duke bere sugjerime dhe aprovuar ndryshimet. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studenti ka mundësi të njihet me tezën e provimit, pas korrigjimit, pasi bëhet edhe sekretimi i tezës. Studenti ka të drejtë të njihet me pikët totale në tezë dhe me pikët për cdo rubrikë. Studenti ka të drejtë të reklamoi vlerësimin në rast se konstaton rubrika të pakorrigjuara apo pikë të mos llogaritura mire. Reklamimi i provimit bëhet nëpërmjet një kërkese me shkrim, që depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit. **(Evidence H.1, Neni 23, pika 3).** Më pas Dekani i fakultetit ngre një komision ad hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korrigjuar provimin.<br>Vendimi i rikorrigjimit merret brënda një jave dhe i bëhet i ditur studentit nëpërmjet sekretarisë mesimore.<br>Vendimi i bashkelidhet proces-verbalit të provimit **(Evidenca H.1, neni 23, Pika 4-5).**<br>Nga takimi me studentet, nuk rezulton të ketë pasur raste të tilla. |
| **Konkluzione** | Studentët kanë një rol aktive në strukturat vendimmarrëse dhe vlerësimin e programit, dhe procedurat për vlerësim dhe reklamim janë përcaktuar me qartësi. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme | Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentet **(Evidence 5.3)** dhe Zyra e karrierës dhe Alumni **(Evidence 5.4)** janë dy njësitë kryesore |

| | |
|---|---|
| në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | në shërbim të formimit të studentëve, krahas Departamentit dhe Sekretarisë mësimore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët është një zyrë e ngritur nga institucioni për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Pas përfundimit të studimeve, kjo ndjekje i kalon Zyrës së Karrierës dhe Alumni **(Evidence 5.7).**<br>Insititucioni nëpërmjet Departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari për studentin. Departamenti ndihmon studentët në vështirësi në përvetësimin e lëndëve, nëpërmjet orëve të konsultimit shtesë për ofruara nga pedagogët. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Institucioni u ofron studenteve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet zyrës së Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët **(Evidence 5.3)** dhe Zyrës së karrierës dhe Alumni **(Evidence 5.4).** Ato organizojnë aktivitete të ndryshme orintuese dhe këshilluese, si dhe informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit, apo i asiston në procesin e aplikimit pranë kompanive me të cilat ka marrëveshje **(Evidenca 5.8).** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Zyra e Karrierës dhe Alumni zotëron një databazë të të gjithë studentëvë të cikleve të studimit të diplomuar, përfshirë pozicionin e tyre të punës apo nëse ato janë akoma në kërkim të punës, këto të dhëna shërbejnë për të identifikuar nivelin e punësimit të të diplomuarve në nivel program dhe viti akademik të dhëna të tilla statistikore mbi punësimin e studentëve pas diplomimit. Megjithatë nuk mungojne edhe veshtirësite në kontaktimin dhe mbajtjen e rekordeve të punësimit të studentëve pas diplomimit, pasi një pjesë e tyre ndryshojne kontaktet, apo janë jashtë vendit dhe nuk arrin të kontaktohen.<br>**(Evidence 5.10).** |
| **Konkluzione** | Zyrat e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Karrierës dhe Alumni ofrojnë shërbime të plota për formimin dhe përsosjen e studentëve, duke përfshirë asistencë akademike dhe këshillim karriere, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | duke krijuar një ambient të orientuar drejt suksesit të tyre gjatë dhe pas studimeve. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| | |
|---|---|
| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Institucioni mundëson përdorimin e platformës Microsoft Teems, për të vënë në dispozicion të studentëve materialet mësimore (Evidence 3.2).<br>Gjatë periudhës së Pandemisë, kur kjo platform filloi të përdorej si mjeti i vetëm i komunikimit, institucioni organizoi trajnim për përdorimin e këtij instrumenti në funksion të mësimdhënjes. Udhëzuesit janë vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve.<br><br>**(Evidence 3.4)** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Stafi akademik vlerësohet periodikisht nga studentët për plotësimin e standartve të mësimdhënjes **(Evidence 3.3, a, b, c, d)** dhe nga pedagogët **(Evidence 3.8).** Ky proces menaxhohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshem te Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, përmes pyetësorëve.<br><br>*Megjithatë, pyetësorët janë shumë të përgjithshëm dhe nuk lejojnë të vlersojnë në mënyrë të detajuar aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së lëndes nga pedagogu.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, | Në fund të cdo semestri, para sezonit të provimeve, studentët plotësojnë një pyetesor për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative. Ky pyetesor është realizuar me Microsoft Form. **(Evidence 3.3, a, b, c, d).** |

| | |
|---|---|
| përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Të dhënat e laboruara nga NJSBC i vihen në dispozicion Departamentit, i cili i diskutorn. Rastet specifike apo shqetësuese diskutohen me personat e interesuar. Vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve përmes emailit.<br>Një analizë e përgjithshme e pyetësoreve bëhet edhe në nivel Universiteti në mbledhjen e Senatit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Analiza e pyetësorëve si në nivel universiteti ashtu edhe e stafit akademik ndikon në nxitjen e praktikave më të mira për permiresimin e cilësisë së mësimdhënjes. |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka integruar teknologjinë, përdorimin e Microsoft Teams dhe trajnimet për përmirësimin e mësimdhënjes gjatë pandemisë. Stafi akademik vlerësohet periodikisht nga studentët dhe pedagogët përmes pyetësorëve, ndërsa të dhënat analizohen në nivel institucional për nxitjen e përmirësimeve. Përdorimi i Microsoft Form për vlerësimin nga studentët dhe praktikat transparente përmes emailit kontribuojnë në sigurimin e cilësisë së mësimdhënjes. Analiza e përgjithshme e pyetësoreve shërben për identifikimin e praktikave më të mira në nivel universiteti.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Albanian University për sigurimin e cilësisë së brëndshme ka ngritur struktura që merren me monitorimin dhe përmiresimin e vazhdueshëm të cilësisë si NJSBC Njësinë e Sigurimit të cilësisë së Brendshme **(Evidence 6.1)**, në përputhje me parshikimet ligjore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion | Në vitin 2009-2010, Albanian Unviersity me vendim senati nr. 178, date 23.07.2010 ka ngritur NJSBC **(Evidence 6.1)**. dhe ne 2016 ka |

| | |
|---|---|
| Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | ngritur Komisionin e Perhershem per Vleresimin Institucional ku perfshin edhe perfaqesues te studenteve **(Evidence 6.2)** në perputhje me ligjin 80/15, me vendim nr. 5 te Senatit Akademik.<br>Studentet janë perfshirë në grupin e punës edhe në procesin e akreditimit insitucional dhe të programeve të studimit.<br>Nga 2016, Në mbeshtetje të cilësisë, Albanina Unviersity ka ngritur dhe grupin e sigurimit te cilesise ne nivel baze, me vencim te Senatit Akademik Nr. 157/3 date 08,09,2016 anëtarët e të cilit përditesohen cdo vit.<br>NJSBC bashkëpunon me ekspert të jashtëm: 1 konsulent juridik **(Evidence 6,5 a)** dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave (**Evidence 6.5, b)** dhe me zyren e zhvillimit të kurrikulave (**Evidence 6.6).** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Albanian University në kuader të sigurimit të cilësisë rekruton staf me grada shekncore. Megjithat në këtë aspekt, universiteti plotëson krieteret minimale, aq më tepër një pjesë e stafit që mbulon lënde të profilit të dizajnit vjen nga fusha e artit si pikture /skulpture dhe nuk ka një profil të mirëfilltë në dizajn grafik. Në këtë aspekt, Institucioni duhet rekrutoj staf me background në dizajn apo me experience dhe portfolio në fushën e dizajnit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | Njesia baze, ne menyre periodike harton raporte (semestrale apo vjetore) **(Evidenca 1.2. a, b, c, d, e)**, ku perfshihen te dhena pershkruese dhe sasiore mbi ceshtje qe lidhen me gjendjen e programit te studimit, vlefshmerine e akreditimit, stafin akademik te rekrutuar, literature e re ne biblioteke, rezultatet e arritura te studenteve, nota mesatare dhe kalueshmeria, etj dhe ne fund realizon nje analize SWOT, dhe masa te marra per permiresimin ne te ardhmen.<br>Nuk ka evidence që institucioni ben promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. |
| **Konkluzione** | Institucioni disponon strukturat per vleresimin e cilesise se brendshme, por mungojne evidenca se institucioni ka ndërmarrë masa konkrete për adresimin e çështjeve të identifikuara në analizën SWOT dhe raportet periodike të hartuara nga njesia baze e sigurimit të cilësisë. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Institucioni ka ngritur Grupet e Sigurimit te Cilesise ne nivel departamenti **(Evidence 6.3 a,b,c,d)**. Këto grupe mbikqyrin programet e studimit, dhe punojne për rishikimin e kurrikulave dhe syllabiseve. Ato janë pjese e grupeve të vleresimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimeve.<br><br>Procesi i sigurimit të cilësisë në Albanian University është një process zinxhiri, i cili përfshin të gjtihe aktoret duke filluar që nga Njësia Baze në grupet e sigurimit të cilësise. Njësia bazë realizon raporte vjetore duke vleresuar në mënyre periodike programin e studimit. Ky raport i përcillet NJSBC-se dhe njësisë Kryesore përkatëse. Nga këtu informacioni kalohet ne instanca më të larta. Në raportin vjetor paraqiten edhe masat e marra në raport me vitin e kaluar si dhe parashikimet për vitin e ardhshëm. |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Raportet e vleresimin jane shume te pergjithshme. *Unviersiteti duhet te mundesoj vleresimin e stafit akademik nga studentet.*<br><br>Po ashtu stafi akademik, duhet te plotesoj ne nivel vjetor nje formular ku deklaron punen akademike, administrative, dhe kerkimore, perfshire botimet, pjesemmarrje ne konferenca, etc.<br>Gjithashtu, departamenti ne raportin vjetor duhet të plotësoj performancën e stafit dhe për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, | Universiteti duhet të përdor një sërë mekanizmash në kuadër të monitorimit dhe përmirësimit të niveleve të cilësisë si: procesi i vlerësimit të studentëve: përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit dhe te pedagogut;<br>Procesi i vlerësimit të kolegëve: ndihmon profesorët të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta, mjetet dhe teknikat e tyre për të përfituar të nxënit e studentëve; procesi i vetëvlerësimit: një mjet për profesorët që u lejon |

| | |
|---|---|
| kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | atyre të reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimdhënies dhe të ndërmarrin hapa për të përmirësuar. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Për monitorimin e vlerësimit të cilësisë, Albanian University përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.<br>Metoda të tërthorta:<br>• Pyetesoret e studentëve, **(Evidence 3.3. a, b, c, d)**<br>• Fokus grupe **(Evidencë 6.7 a, b, c, d)**<br>• Raporte vetvlerësimi të pedagogeve, **(Evidencë 3.8)**<br>• Raporte vetevlerësimi të njësisë baze, 2 here ne vit. **(Evidencë 1.2., a, b, c, d, e)**<br>Metodat e drejtpërdrejta:<br>• Vlerësimi me notë dhe pikë<br>• Teste paraprake dhe përfundimtare<br>• Vezhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve.<br>• Statistikat e studenteve<br>• Rishikimi i syllabuseve.<br>• Pyetësor për personelin akademik **(Evidence 6.9)**<br><br>Përvec këtyre metodave, Universiteti duhet të përdor sistemin e trefishtë të vlerësimit: a. vleresimi i studentëve për pedagogët dhe mësimdhënjen, b. vlerësimi i pedagogut nga koleget, dhe c. vetvlerësimi i pedagogut. |
| **Konkluzione** | Sistemi i vleresimit e cilësise të përdorur aktualisht nga universiteti, nuk nxjerr në pah problematika dhe cështje që mund të jenë subjekt përmiresimi.<br>Universiteti duhet të përdor sistemin e trefishte te vleresimit te cilesise: a. vleresimi i studenteve per pedagoget dhe mesimdhenjen, b. vleresimi i pedagogut nga koleget, dhe c. vetvleresimi i pedagogut. Ky sistem duhet të jetë i detajuar në cdo zë. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi VI.4** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni bashkëpunon me ekspert të jashtëm për përmirësimin e parametrave të cilësisë si dhe me Njësine baze qëII ofron programin e studimit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në rregulloren e NJSBC janë parashikuar detyrat e paleve të përfshira në vlerësimin e cilësisë **(Evidenca 6.10).**<br>Në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e NJSBC. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit perfshihen njësite bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.<br>Per te gardantuar nje vleresim shume dimensional universiteti duhet te krijoj nje system te trefishte vleresimi:<br>• Vleresimi nga Koleget<br>Vleresimi nga Studentet<br>Vlerësimi i performancës individuale |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Institucioni respekton të drejtat e aktoreve te perfshire ne proceset e vleresimit, siguron integritetin akademik dhe shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, duke respektuar Kodin e Etikes te Albanian Unviersity **(Evidenca 6.11).** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Në kuadër të procesit të vleresimit institucional ka marre masat e meposhtme per permbushjen e sugjerimeve dhe rekomandimeve te lena nga ekspertet e jashtem.<br>• Institucioni ka rekrutuar personel me tituj dhe grad shkencore;<br>• Institucioni ka pasuruar biblioteken duke u abonuar ne platformën Elia, specifike për dizajn, si dhe ka shtuar numrin e titujve ne biblioteke; |
| **Konkluzione** | Institucioni ka potencial për të rritur standardet e cilësisë, por ka nevojë për një përqasje më gjitheperfshirese ne vleresim nga pjesëmarrësit kryesorë, duke përfshirë studentët dhe stafin akademik. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Raporti i prodhuar nga Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë publikohet ne faqen web te universitetit duke u bere publike, transparente dhe te aksesueshme ng ate gjithe. Raporti vjetor ne nivel universiteti publikohet ne faqen web. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Raporti vjetori I veprimtarive mesimore dhe kerkimore shkencore te institucionit perfshin te dhena statistikore per secilin program studimi ruhen ne respect te lirise dhe etikes si dhe ne perputhje me legjislacionin për të dhënat personale.<br>Universiteti nuk paraqet vleresime specifike per cdo pedagog, por vetem nje formular te pergjithshem per vleresimin e institucionit, programit dhe performances se pedagogeve ne pergjithesi. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Raporti vjetror shoqerohet edhe me nje plan masash qe adresojne problematikat e raprotit te vitit te kaluar si dhe nje planveprim per vitin e ardhshem.<br>Masat e marra jane te pakta dhe nuk reflektojne problematikat, dobesite dhe potencialet e shprehura ne Analizen SWAT te vitit paraardhes. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Raporti vjetro shoqerohet edhe me nje plan masash qe adresojne problematikat ehe nje planveprim per vitin e ardhshem. Masat e marra jane te pakta dhe nuk reflektojne problematikat, dobesite dhe potencialet e shprehura ne Analizen SWAT te vitit paraardhes. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni ne fillim te cdo viti akademik ne javet orientuese, si dhe pas cdo procesi te vleresimit te jashtem, informon studnetet dhe stafin akademik mbi rendesine e vleresimit te cilesise, permiresimit te cilesise dhe akreditetimit te programit te studimit. |
| **Konkluzione** | ***Mungesa e reflektimit te pikave kritike të raportit final në vitin pasardhës:*** *Raporti vjetor shoqërohet me një plan masash dhe një planveprim për vitin e ardhshëm, por masat e marra janë të pakta dhe nuk reflektojnë në mënyrë të mjaftueshme problematikat dhe potencialet e identifikuara në analizën SWOT.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | X | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Dizajn" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë " Albanian Universiy"</u>**

**Pikat e Forta:**

**1. Kërkesa e Lartë nga Tregu:** Programi është shumë i kërkuar nga tregu i punës, duke kontribuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe imazhin e markave të bizneseve.

**2. Interesi i Lartë i Studentëve:** Vërehet një rritje e konsiderueshme e regjistrimeve të studentëve, çka dëshmon rëndësinë dhe tërheqjen e programit.

**3.Struktura e Kurrikulës:** Kurrikula është në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar që studentët të ndërtojnë gradualisht njohuritë e tyre përmes kombinimit të moduleve teorike dhe praktike.

**Pikat e Dobëta**

**1. Mungesa e Stafit të Specializuar (Kriteri 1, Standardi VI.2):** Departamenti nuk ka mjaftueshëm staf të specializuar në fusha kyçe si dizajni UX/UI, dizajni i ndërveprimit dhe grafika në lëvizje. Kjo kërkon një përmirësim në planin e rekrutimit për të tërhequr profesionistë të kualifikuar.

*Standardi VI.2 thekson nevojën për të zbatuar politika që sigurojnë rekrutimin e stafit me ekspertizë të duhur për të përmbushur standardet akademike.*

**2. Mungesa e Bashkëpunimeve Ndërkombëtare (Kriteri 5, Standardi III.2):** Ka një mungesë të bashkëpunimeve dhe mundësive të shkëmbimit me universitetet europiane, çka zvogëlon mobilitetin e studentëve dhe kufizon mundësitë e kërkimit shkencor ndërkombëtar.

*Standardi III.2 nënvizon rëndësinë e partneriteteve dhe bashkëpunimeve me institucione të huaja për të përmirësuar përvojën e të nxënit për studentët.*

**3. Mungesa e Mundësive për Kërkime Shkencore (Kriteri 4, Standardi I.2):** Ka mungesë të angazhimit shkencor në këtë fushë dhe një numër të kufizuar të mundësive të strukturuara për kërkime për studentët dhe stafin.

*Standardi I.2 kërkon përfshirje më të madhe të institucioneve të arsimit të lartë në zhvillimin e kërkimeve profesionale dhe inovacionit.*

**4. Infrastruktura dhe Pajisjet (Kriteri 4, Standardi I.1):** Infrastrukturat dhe laboratorët ekzistues janë të pamjaftueshëm për nevojat bashkëkohore të studentëve. Universiteti duhet të investojë më shumë në laboratorët e dizajnit dhe në teknologji të avancuara.

*Standardi I.1 përcakton që infrastruktura duhet të jetë në përputhje me nevojat e studentëve dhe të sigurojë mundësi për praktika të avancuara.*

**5. Shpërndarja e Ngarkesës së Stafit (Kriteri 4, Standardi I.2):** Ka një shpërndarje të pabalancuar të ngarkesës akademike ndërmjet pedagogëve, çka ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe në përvojën studentore.

*Standardi I.2 thekson nevojën për të siguruar një shpërndarje të balancuar të ngarkesës akademike për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.*

**Mundësitë:**

**1. Zgjerimi në Dizajnin Dixhital:** Kërkesa për aftësi dixhitale si dizajni UX/UI dhe grafika në lëvizje ofron një mundësi për të zgjeruar dhe rishikuar programin për të përfshirë këto fusha të reja.

**2. Forcimi i Partneriteteve Ndërkombëtare:** Universiteti ka mundësi për të zhvilluar marrëdhënie më të forta me universitetet europiane për kërkime dhe shkëmbime studentore.

**Rreziqet:**

**1. Konkurrenca nga Institucione të Tjera:** Pa adresimin e mangësive në staf dhe kërkim shkencor, programi rrezikon të humbasë konkurrencën në tërheqjen e talenteve më të mira.

**2. Bashkëpunim i Kufizuar me Industrinë:** Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me kompani dhe agjenci reklamash ndikon negativisht në mundësitë praktike për studentët, duke reduktuar përvojën e tyre reale dhe duke ulur vlerën e diplomës në tregun e punës.

**3. Numri i Kufizuar i Mobiliteteve Ndërkombëtare:** Mungesa e mobilitetit ndërkombëtar për studentët dhe stafin e bën programin më pak tërheqës krahasuar me universitetet që ofrojnë më shumë mundësi shkëmbimi dhe eksperiencë ndërkombëtare.

**Rekomandime:**

- **Rekrutimi i Stafit të Specializuar (Kriteri 1, Standardi VI.2):** Departamenti duhet të zhvillojë një plan strategjik për rekrutimin e stafit të specializuar në fusha kyçe si dizajni UX/UI, dizajni i ndërveprimit, dhe grafika në lëvizje. Rekomandohet të bashkëpunoni me industrinë për të identifikuar profesionistë me përvojë në këto fusha.
- **Zgjerimi i Bashkëpunimeve Ndërkombëtare (Kriteri 5, Standardi III.2):** Institucioni duhet të ndërmarrë hapa për të zgjeruar partneritetet me universitete të tjera europiane dhe ndërkombëtare, duke rritur mundësitë për mobilitet dhe shkëmbime akademike. Rekomandohet të nënshkruhen marrëveshje dypalëshe dhe të përfshihen programe si Erasmus+, duke mundësuar studentëve dhe stafit të përfitojnë nga përvojat ndërkombëtare. Kjo do të përmirësojë ekspozimin e tyre ndaj metodave dhe trendeve bashkëkohore në dizajn.
- **Rritja e Mundësive për Kërkime Shkencore (Kriteri 4, Standardi I.2):** Për të përmirësuar angazhimin në kërkime shkencore, institucioni duhet të aplikoj ne projekte kërkimore të strukturuara për studentët dhe stafin. Sugjerohet krijimi i fondeve për projekte kërkimore dhe organizimi i konferencave dhe seminareve kërkimore nga ana e departamentit. Për më tepër, bashkëpunimi me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare mund të krijojë më shumë mundësi për përfshirjen dhe financimin e projekte kërkimore të avancuara.
- **Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Pajisjeve (Kriteri 4, Standardi I.1):** Universiteti duhet të investojë në modernizimin e infrastrukturës dhe laboratorëve të dizajnit, duke siguruar pajisje dhe teknologji të përparuar si printera 3D, pajisje për prerje me lazer, dhe pajisje elektronike /softuerë për dizajn grafik dhe ndërveprues (

si ipad/Wacom). Kjo do të përmirësojë mundësitë praktike të studentëve dhe do të lehtësojë zhvillimin e projekteve inovative dhe praktike.

- **Balancimi i Ngarkesës Akademike të Stafit (Kriteri 4, Standardi I.2):** Institucioni duhet të ndërmarrë hapa për të balancuar më mirë ngarkesën akademike ndërmjet stafit pedagogjik. Rekomandohet të rishikohen orët e mësimdhënies për të shmangur mbingarkesën e disa pedagogëve në menyrë që të sigurohet cilësi e lartë e mësimdhënies. Kjo mund të arrihet përmes një riorganizimi të brendshëm të stafit dhe ndarjes më të drejtë të ngarkesës.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Design" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"**

**Strengths:**

1. **High Market Demand:** The program is highly sought after by the labor market, positively contributing to economic development and enhancing the brand image of businesses.
2. **High Student Interest:** A significant increase in student enrollments indicates the importance and appeal of the program.
3. **Curriculum Structure:** The curriculum aligns with international standards, ensuring that students build their knowledge gradually through a combination of theoretical and practical modules.

**Weaknesses:**

1. **Lack of Specialized Staff (Criterion 1, Standard VI.2):** The department lacks sufficient specialized staff in key areas such as UX/UI design, interaction design, and motion graphics. This requires an improvement in the recruitment plan to attract qualified professionals.

*Standard VI.2 emphasizes the need to implement policies ensuring the recruitment of staff with the appropriate expertise to meet academic standards.*

2. **Lack of International Collaborations (Criterion 5, Standard III.2):** There is a lack of collaborations and exchange opportunities with European universities, reducing student mobility and limiting international research opportunities.

*Standard III.2 underscores the importance of partnerships and collaborations with foreign institutions to enhance students' learning experiences.*

3. **Lack of Research Opportunities (Criterion 4, Standard I.2):** There is a lack of scientific engagement in this field and a limited number of structured research opportunities for students and staff.

*Standard I.2 calls for greater involvement of higher education institutions in the development of professional research and innovation.*

4. **Infrastructure and Equipment (Criterion 4, Standard I.1):** Existing infrastructures and laboratories are inadequate for contemporary student needs. The university needs to invest more in design labs and advanced technologies.

*Standard I.1 states that infrastructure must meet student needs and provide opportunities for advanced practices.*

5. **Uneven Staff Workload (Criterion 4, Standard I.2):** There is an imbalance in academic workload among instructors, affecting the quality of teaching and the student experience.

*Standard I.2 stresses the need to ensure a balanced distribution of academic workloads to improve teaching quality.*

**Opportunities:**

1. **Expansion in Digital Design:** The demand for digital skills such as UX/UI design and motion graphics offers an opportunity to expand and revise the program to include these new fields.
2. **Strengthening International Partnerships:** The university has the opportunity to develop stronger relationships with European universities for research and student exchanges.

**Threats:**

1. **Competition from Other Institutions:** Without addressing the deficiencies in staff and research, the program risks losing competitiveness in attracting top talent.
2. **Limited Industry Collaboration**: Insufficient collaboration with companies and advertising agencies negatively impacts practical opportunities for students, reducing their real-world experience and lowering the program's value in the job market.
3. **Limited International Mobility:** The lack of international mobility for students and staff makes the program less attractive compared to universities offering more exchange and international experience opportunities.

**Recommendations:**

- **Recruitment of Specialized Staff (Criterion 1, Standard VI.2):** The department should develop a strategic plan for recruiting specialized staff in key areas such as UX/UI design, interaction design, and motion graphics. It is recommended to collaborate with the industry to identify experienced professionals in these fields.

- **Expansion of International Collaborations (Criterion 5, Standard III.2):** The institution should take steps to expand partnerships with other European and international universities, increasing opportunities for mobility and academic exchanges. It is recommended to sign bilateral agreements and engage in programs like Erasmus+, enabling students and staff to benefit from international experiences. This will expose them to contemporary methods and trends in design.

- **Increase Research Opportunities (Criterion 4, Standard I.2):** To improve engagement in scientific research, the institution should apply for structured research projects for students and staff. It is suggested to create research project funds and organize research conferences and seminars by the department. Furthermore, collaboration with international universities and research institutions could create more opportunities for involvement and funding of advanced research projects.

- **Improve Infrastructure and Equipment (Criterion 4, Standard I.1):** The university should invest in modernizing infrastructure and design laboratories, ensuring advanced equipment and technologies like 3D printers, laser cutting machines, and electronic devises/software for graphic and interactive design (ex. Ipad/Wacom). This will enhance practical opportunities for students and facilitate the development of innovative and hands-on projects.

- **Balance Staff Workload (Criterion 4, Standard I.2):** The institution should take steps to better balance academic workloads among the teaching staff. It is recommended to review teaching hours to avoid overloading certain instructors, ensuring high-quality teaching. This can be achieved through internal staff reorganization and more equitable distribution of workloads.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | X | |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, | | | X | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | X | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |